



Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET E QEVERISJES VENDORE

8 maj 2011

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
Raporti Përfundimtar



Varshavë
15 gusht 2011

PËRMBAJTJA

I.	PËRMbledhje Ekzekutive	2
II.	HYRJE DHE FALENDERIME	3
III.	SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK	4
IV.	KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR	5
A.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	5
B.	SISTEMI ZGJEDHOR	6
V.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	7
A.	KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE.....	7
B.	KOMISIONET E ZONA VE TË ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE.....	8
C.	KOMISIONET E QENDRA VE TË VOTIMIT DHE GRUPET E NUMËRIMIT.....	8
D.	VLERËSIMI I ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE NË PERIU DHËN PARAZGJEDHORE.....	9
VI.	REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE	10
VII.	REGJISTRIMI I PARTIVE DHE KANDIDATËVE	12
VIII.	FUSHATA ZGJEDHORE	13
A.	FINANCAT E FUSHATËS	16
IX.	MEDIA	17
A.	MJEDISI MEDIATIK	17
B.	KUADRI LIGJOR PËR MEDIAN.....	17
C.	MONITORIMI I MEDIAS.....	18
X.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	20
XI.	PJESËMARRJA E GRAVE	21
XII.	VËZHGESIT VENDAS	22
XIII.	ANKESAT DHE APELIMET PËR PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE	22
XIV.	VOTIMI DHE NUMËRIMI	23
A.	QENDRAT E VOTIMIT	23
B.	VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE.....	25
C.	NUMËRIMI DHE VLERËSIMI I VOTAVE NË TIRANË.....	26
XV.	MBLEDHJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE NGA KQZ-JA	29
XVI.	ANKESAT DHE APELIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE	29
A.	GJYKIMI I ANKESAVE PASZGJEDHORE NGA KQZ-JA	29
B.	GJYKIMI I APELIMEVE PASZGJEDHORE NGA KOLEGJI ZGJEDHOR	30
XVII.	REKOMANDIME	32
A.	REKOMANDIME PRIORITARE.....	33
B.	REKOMANDIME TË TJERA	34

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET E QEVERISJES VENDORE

8 maj 2011

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve

Raporti Përfundimtar¹

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vijim të një ftese të Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë drejtuar Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) për të vëzhguar zgjedhjet e qeverisjes vendore të 8 majit 2011, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dërgoi Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) në Republikën e Shqipërisë. Zgjedhjet u vlerësuan për përputhshmërinë e tyre me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si edhe me legjislacionin vendas. Për vëzhgimin gjatë ditës së zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i bashkoi përpjekjet me Kongresin e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës.

Zgjedhjet për qeverisjen vendore u zhvilluan në një atmosferë politike që arriti në një pikë krize pas përplasjeve të dhunshme ndërmjet demonstruesve antiqeveritarë dhe policisë më 21 janar 2011 që çuan në katër të vdekur. Ndërkohë që zgjedhjet ishin konkurruese dhe transparente, ato ishin tejet të polarizuara, me mungesë besimi ndërmjet partive politike në qeveri dhe opozitës. Sikundër në zgjedhjet pararendëse, dy partitë e mëdha nuk i përmbushën detyrat e tyre zgjedhore me përgjegjshmëri, duke ndikuar negativisht në administrimin e zgjedhjeve. Anshmëria partiake dhe mosmarrëveshjet e ashpra brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) gjatë përgatitjeve për zgjedhje e dobësoi aftësinë e tij për të kapërcyer boshllëqet dhe paqartësitë në Kodin Zgjedhor në mënyrë të efektshme dhe me kolegjalitet.

Partitë dhe kandidatët u regjistruan në nivel vendor në një proces kryesisht gjithëpërfshirës, dhe zhvilluan një fushatë aktive në mbarë vendin; megjithatë, raste të shumta dhune u shënuan gjatë periudhës së fushatës. Ndonëse u vërejtën më pak abuzime me burimet administrative për qëllime fushate sesa në zgjedhjet e mëparshme, përpjekjet e organizuara për t'u bërë presion apo për t'i frikësuar zgjedhësit vazhduan. Megjithëse media është ndarë në linja partiake, pluraliteti dhe larmia e operatorëve mediatikë i lejoi zgjedhësit të zgjidhnin mes një numri alternativash politike. Megjithatë, në kundërshtim me ligjin, media audiovizive shpesh pasqyroi anshmëri politike gjatë mbulimit të fushatës dhe nuk u dha kohë të mjaftueshme televizive partive më të vogla. Pjesëmarrja e grave mbeti e ulët, pjesërisht për shkak të mosplotësisimit nga ana e partive të kriterit gjinor gjatë përpilimit të listave të kandidatëve për këshillat vendore.

Ditën e zgjedhjeve, votimi u zhvillua relativisht mirë në shumicën e 384 njësiteve të qeverisjes vendore, por megjithatë, pati probleme serioze në rreth 10 përqind të qendrave të votimit në drejtim të plotësisimit të kërkesave ligjore. Ato kishin të bënin me garantimin e fshehtësisë së votës dhe zbatimin e masave të sigurisë për integritetin e procesit zgjedhor. Ndërkohë që procesi i numërimit u vlerësua në përgjithësi pozitivisht, ai ishte shumë i gjatë dhe në disa vende u shënuan vonesa të panevojshme dhe ndërhyrje prej partive politike. Në disa vende të numërimit të votave, procesi i numërimit nuk iu përmbajt gjithmonë kërkesave procedurale.

Veprimet paszgjedhore të ndërmarra nga KQZ-ja lidhur me rezultatin e garës për kryetarin e

1 Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar. Në shqip ofrohet përkthimi jozyrtar.

bashkisë së Tiranës që u kundërshtuan ashpër, ndonëse të mbështetura pjesërisht prej Kolegjit Zgjedhor, e lëkundën edhe më shumë besimin se KQZ-ja po vepronte si një organ i paanshëm dhe i pavarur. Shqyrtimi i ankesave dhe apelimeve në periudhën paszgjedhore nuk ofroi zgjidhje të efektshme në të gjitha rastet, ndonëse Kolegji Zgjedhor i anuloi zgjedhjet në disa zona zgjedhore për shkak të parregullsive. Ndryshe nga këto raste, apeli gjatë periudhës parazgjedhore u gjykuan shpejt çka ofroi zgjidhje të efektshme .

Këto ishin zgjedhjet e para për qeverisjen vendore që nga ndryshimi i Kushtetutës dhe miratimi i Kodit të ri Zgjedhor në 2008. Kodi Zgjedhor u vlerësua paraprakisht nga OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni European për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) si një kod që ofron një themel teknik të kompletuar për zgjedhjet. Megjithatë, disa dispozita mbeten në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Në veçanti, dy partitë më të mëdha politike kanë të drejtën të heqin secila nga një gjyqtar nga ata të përzgjedhur për të gjykuar apeli me zgjedhore, duke dëmtuar pavarësinë e gjyqësorit. Për më tepër, në Kodin Zgjedhor ekzistojnë boshllëqe dhe paqartësi serioze në lidhje me zgjedhjet vendore.

KQZ-ja i kreu përgatitjet komplekse teknike për zgjedhjet përgjithësisht në mënyrë transparente. Megjithatë, klima politike ndikoi në punën e saj ashtu sikurse edhe mosmarrëveshjet nëse disa vendime mund të merreshin me shumicë të thjeshtë apo kërkonin shumicë të cilësuar votash. Komisionet zgjedhore të nivelit më të ulët punuan në kolegjalitet; megjithatë, shumë afate u shkelën, shpesh si pasojë e mosplotësisht të përgjegjësisë ligjore prej partive. Këto vonesa e dëmtuan administrimin e zgjedhjeve dhe ndikuan në njëtrajtshmërinë e procesit, duke përfshirë votimin, numërimin e votave dhe nxjerrjen e tabelave të rezultateve.

Autoritetet bënë përpjekje serioze për të eliminuar nga listat e zgjedhësve regjistrimet e shumëfishta dhe personat e vdekur. Pavarësisht këtij progresi, vazhdojnë çështjet lidhur me saktësinë dhe plotësinë e listave. Autoritetet e pranuan si një problem që vazhdon ende mungesën e regjistrimit civil dhe dokumenteve të identifikimit për komunitetin rom dhe egjiptian, çka mund të ketë çuar në disa raste në heqjen e të drejtës së tyre për të votuar.

Me anë të një procesi gjithëpërfshirës, KQZ-ja akreditoi 4,617 vëzhgues vendas nga 19 OJF të ndryshme. Raportimet e disa prej këtyre grupeve e përmirësuan transparencën e përgjithshme të procesit zgjedhor. Përfaqësuesit e partive dhe koalicioneve ishin të pranishëm në pothuaj të gjitha qendrat e votimit dhe vendet e numërimit të votave.

Ndonëse pati aspekte pozitive të zgjedhjeve që përgatitën kushtet për progres në të ardhmen, ky progres kushtëzohet nga vullneti i të gjitha partive parlamentare për t'u angazhuar në reformën zgjedhore. Kjo duhet ndërmarrë së bashku me autoritetet qeveritare, administruesit e zgjedhjeve dhe shoqërinë civile. Në këtë drejtim, OSBE/ODIHR-i ofron një numër rekomandimesh për një përmirësim të mëtejshëm të cilat duhet të merren parasysh së bashku me rekomandimet nga raportet dhe vlerësimet ligjore të mëparshme të OSBE/ODIHR-it. OSBE/ODIHR-i vazhdon të jetë i gatshëm që të mbështesë procesin e reformës zgjedhore në Republikën e Shqipërisë.

II. HYRJE DHE FALENDERIME

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Bamir Topi, shpalli më 6 shtator 2010 se zgjedhjet për qeverisjen vendore do të zhvilloheshin më 8 maj 2011. Këto zgjedhje zhvilloheshin për kryetarët e bashkive, komunave dhe këshillat e 384 njësisve të qeverisjes vendore (NjQV) të Shqipërisë. Në vijim të ftesës së mëparshme nga Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë drejtuar Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Europë (OSBE) më 5 nëntor 2010, Zyra e OSBE-së për

Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dërgoi në Tiranë një Mision të Vlerësimit të Nevojave (MVN) nga 17 deri më 21 janar 2011.²

Në bazë të rekomandimeve të MVN-së së OSBE/ODIHR-it, më 28 mars u vendos një Mision i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ). MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, e kryesuar nga Z. Jonathan Stonestreet, përbëhej prej një ekipi bazë prej 16 anëtarësh në Tiranë dhe 24 vëzhguesish afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin. Për ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it shpërnda 298 vëzhgues afatshkurtër. Në përgjithësi, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it përfshinte vëzhgues nga 35 shtete pjesëmarrëse në OSBE.

MVZ-së së OSBE/ODIHR-it iu shtua edhe një delegacion prej 17 anëtarësh nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës për të vëzhguar ditën e zgjedhjeve. Procedurat e hapjes u vëzhguan në 75 Qendra Votimi (QV). Procedurat e votimit u vëzhguan në mbi 1,000 QV nga një numër i përgjithshëm prej 4,882 qendrash. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi gjithashtu numërimin e fletëve të votimit dhe hartimin e tabelave të rezultateve në 57 nga 66 Vendet e Numërimit të Votave (VNV). Një numër i vogël i vëzhguesve afatshkurtër qëndroi deri më 15 maj për të vëzhguar numërimin e zgjatur të fletëve të votimit për bashkinë e Tiranës.

Zgjedhjet u vlerësuan në drejtim të përputhjes së tyre me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike si edhe me legjislacionin vendas. Raporti përfundimtar pason Deklaratën e Konstatimeve dhe Përfundimeve Paraprake, e cila u publikua në një konferencë për shtyp në Tiranë më 10 maj.³

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i shpreh falënderimet Ministrisë së Punëve të Jashtme për ftesën e bërë për të vëzhguar zgjedhjet, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për bashkëpunimin dhe pajisjen me dokumentet e akreditimit, dhe autoriteteve të tjera në nivel kombëtar dhe vendor për ndihmesën dhe bashkëpunimin. Gjithashtu, Misioni i OSBE/ODIHR-it dëshiron të shprehë vlerësimin e tij për Praninë e OSBE-së në Shqipëri për bashkëpunimin dhe mbështetjen e saj.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e 8 majit ishin të parat zgjedhje vendore të zhvilluara që nga ndryshimi i Kushtetutës dhe miratimi i mëvonshëm i Kodit të ri Zgjedhor në vitin 2008. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, koalicioni zgjedhor i kryesuar nga Partia Demokratike (PD) fitoi 70 nga 140 vendet në parlament dhe krijoi qeverinë me Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI), e cila fitoi 4 vende. Rezultatet e zgjedhjeve u kundërshtuan nga Partia Socialiste (PS) dhe deputetët e saj bojkotuan parlamentin deri në mars 2010.

Pas zgjedhjeve të vitit 2009, mjedisi politik mbeti mjaft i polarizuar, i karakterizuar nga retorika të ashpra dhe sulme personale, si edhe me demonstrata të opozitës. Tensioni u rrit pas një proteste anti-qeveritare organizuar nga PS-ja më 21 janar 2011, kur përplasje të ashpra u zhvilluan ndërmjet protestuesve dhe forcave të rendit. Katër persona mbetën të vrarë dhe shumë të tjerë u plagosën. Parlamenti nisi një hetim, ndërsa Prokuroria e Përgjithshme hapi një hetim më vete për të shtënat me armë. Këto hetime vazhdonin edhe gjatë kohës së zhvillimit të zgjedhjeve të 8 majit.

2 Të gjitha raportet e OSBE/ODIHR-it mbi zgjedhjet në Shqipëri janë të disponueshme në faqen e internetit www.osce.org/odihr/elections/albania.

3 Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it botoi gjithashtu dy raporte paraprake dhe një raport paraprak pas zgjedhjeve.

Pas ngjarjeve të 21 janarit, ishin të shumta vizitat e ndërkombëtarëve të nivelit të lartë gjatë të cilave u bënë thirrje për qetësi dhe përgjegjshmëri në periudhën përpara zgjedhjeve. Presidenti Topi u kërkoi të gjitha partive që të sillleshin në mënyrë të përgjegjshme dhe të vepronin në përputhje me ligjin. Që të dy kryetarët, ai i mazhorancës dhe ai i opozitës, deklaruan se prioriteti i tyre ishte që zgjedhjet të zhvilloheshin në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare. Megjithatë, partitë e opozitës shprehën mosbesimin në autoritetet dhe në administratën zgjedhore, ndërsa partitë qeverisëse pretenduan se komisionerët e emëruar nga opozita do të pengonin procesin. PS-ja kërkoi masa shtesë sigurie për procesin zgjedhor, përfshirë aksesin e partive politike në përgatitjen e listave të zgjedhësve, skanimin e kartave të identitetit, rinumërimin e fletëve të votimit nëse kërkohej prej dy anëtarëve të KQZ-së, dhe kqyrjen pas zgjedhjeve të materialeve zgjedhore.

Në fund të marsit 2011, nën kujdesin e komunitetit ndërkombëtar, me anë të një diskutimi në tavolinë të rrumbullakët të partive parlamentare u përpoq të arrihej “një marrëveshje e vullnetit të mirë” për përgjegjësitë e partive në procesin zgjedhor. Të gjitha partitë e firmosën marrëveshjen përveç PS-së, e cila e refuzoi me argumentin se propozimet e saj nuk ishin pranuar.

Shumë parti të vogla shprehën pakënaqësi lidhur me Kodin Zgjedhor, i cili u dukej se favorizonte dy partitë më të mëdha. Ato kundërshtuan dominimin e administrimit të zgjedhjeve prej këtyre partive, si edhe kushtet për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet vendore, të cilat u dukeshin shumë të paarritshme për partitë e vogla që nuk janë pjesë e koalicioneve zgjedhore.

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

A. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Zgjedhjet vendore të vitit 2011 u zhvilluan në një kuadër ligjor i cili përbëhej kryesisht prej Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor. Dispozitat e parashikuara nga Kodi Zgjedhor u mbështetën dhe u vunë në zbatim me anë të vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së. Ligjet e tjera që u zbatuan përfshinin Ligjin mbi Qeverisjen Vendore, Ligjin mbi Partitë Politike⁴ dhe Ligjin mbi Demonstratat, sikurse edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Procedurës Administrative dhe Kodit Penal.

Kodi Zgjedhor është produkt i reformave zgjedhore nisur pas zgjedhjeve vendore të vitit 2007 dhe është hartuar e mbështetur nga PD-ja dhe PS-ja. Ai trajtoi një sërë rekomandimesh të ofruara paraprakisht nga OSBE/ODIHR-i, dhe është vlerësuar se ofron një themel teknik të kompletuar për zgjedhjet.⁵ Megjithatë, disa rekomandime të hershme, përfshirë ato të Raportit Përfundimtar të Misionit të OSBE/ODIHR-it mbi zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, ende nuk janë trajtuar.

Disa dispozita të Kodit Zgjedhor janë në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së, standardet e tjera ndërkombëtare dhe praktikat e mira. Neni 146.3 u jep secilës prej dy partive më të mëdha parlamentare të shumicës dhe opozitës të drejtën për të përjashtuar një nga gjyqtarët e përzgjedhur me short për gjykimin e apelineve zgjedhore. Kjo është e papajtueshme me parimin e pavarësisë

4 Ky ligj u ndryshua ndjeshëm në shkurt 2011, veçanërisht lidhur me financimin e partive politike dhe shtimin e numrit të anëtarëve themelues të nevojshëm për të regjistruar një parti politike nga 500 në 3,000.

5 Shih Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për Zgjedhjet Parlamentare 2009 në Republikën e Shqipërisë dhe Opininion e Përbashkët të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias mbi Kodin Zgjedhor në faqen e internetit www.osce.org/odihr/elections/albania/36587.

së gjyqësorit.⁶ Më tej, nenet 32.2 dhe 39.2 u japin partive politike të drejtën e pakufizuar për të zëvendësuar anëtarë të komisioneve zgjedhore të nivelit të mesëm dhe të ulët sipas dëshirës dhe pa asnjë shkak ligjor, duke dëmtuar kështu pavarësinë e administratës zgjedhore.⁷

Për më tepër, Kodi Zgjedhor mbart disa mangësi dhe paqartësi, të lidhura veçanërisht me zgjedhjet vendore. Për shembull, nuk është e qartë nëse ekziston ndonjë prag minimal për përfaqësimin në këshillat vendore; dispozitat lidhur me financimin e fushatës prej fondeve publike janë të papërcaktuara; dhe nuk ka ndonjë dispozitë lidhur me organin kompetent të administrimit zgjedhor për regjistrimin e kandidatëve për bashkinë e Tiranës. Gjithashtu, nuk ka ndonjë dispozitë të qartë të rolit të KQZ-së në zgjedhjet për bashkinë e Tiranës. Boshllëqe ose paqartësi të tjera që u përkasin si zgjedhjeve vendore ashtu edhe atyre parlamentare përfshijnë afatin e hartimit të Listave Përfundimtare të Zgjedhësve (LPZ), emërimin e anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe grupet e numërimit të votave, dispozitat për identifikimin e reklamave politike në median audiovizive, dhe dispozitat për votat e kontestuara.⁸

Përveç këtyre, Kodi Zgjedhor nuk parashikon vlefshmërinë e votave të hedhura në kutinë e gabuar. Kodi Zgjedhor nuk e thotë shprehimisht që këto vota nuk janë të vlefshme, as nuk parashikon ndonjë procedurë për numërimin e votave të hedhura gabim dhe për përfshirjen e tyre në rezultat. Ky boshllëk shkaktoi polemika të konsiderueshme dhe një proces të tejzgjatur ankimor në zgjedhjet për kryetarin e bashkisë së Tiranës.

B. SISTEMI ZGJEDHOR

Kryetarët e bashkive, komunave dhe këshillat e 384 njërive të qeverisjes vendore (NjQV) zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Zona zgjedhore për zgjedhjet vendore është territori i bashkisë ose komunës. Në Tiranë, ekzistojnë dy nivele të qeverisjes vendore. Qyteti formon një zonë zgjedhore, sikurse formon secila prej 11 minibashkive në të cilat është ndarë qyteti. Kryetarët e bashkive dhe komunave zgjidhen sipas sistemit mazhoritar, ndërsa kandidatët e këshillave zgjidhen nga lista shumëemërore e kandidatëve sipas sistemit proporcional.

Ligji mbi Qeverisjen Vendore parashikon që numri i anëtarëve të këshillave që do të zgjidhen në çdo NjQV përcaktohet sipas popullatës, duke variuar nga 13 anëtarë në komunat më të vogla deri në 45 anëtarë në qytetet me 100,000 dhe 200,000 banorë. Ligji mbi Qeverisjen Vendore nuk parashikon numrin e anëtarëve të këshillave që do të zgjidhen në qytetet me mbi 200,000 banorë. Për Tiranën, Ligji mbi Qeverisjen Vendore parashikon një këshill me 55 vende.

Në Kodin Zgjedhor nuk ekzistojnë dispozita të veçanta mbi zbatueshmërinë e pragueve për shpërndarjen e vendeve në këshillat vendore. Në mungesë të një parashikimi të qartë, KQZ-ja

6 Paragrafi 5.12 i Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagenit 1990, Pika 19.1 dhe 19.2 i Dokumentit të OSBE-së të Moskës 1991 dhe Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit (zyrtarizuar nga rezoluta 40/32 dhe 40/146 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (1985).

7 Angazhimet Ekzistuese të OSBE/ODIHR-it për Zgjedhje Demokratike në Shtetet Pjesëmarrëse në OSBE, Pjesa 2, Pika 4.2, thuhet: “Emërimet në pozicionet e administrimit të zgjedhjeve në të gjitha nivelet duhen bërë në mënyrë transparente, dhe personat e emëruar nuk përjashtohen nga pozicioni i tyre përpara mandatit, përveçse për shkaqe ligjore.” Në Kodin e Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore përpiluar nga Komisioni i Venecias, Kapitulli 3.1, Pika 77 thuhet: “...organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të kenë të drejtën t’i tërheqin, pasi kjo hedh dyshime mbi pavarësinë e tyre. Tërheqja e tyre pa shkak është e papranueshme, por tërheqja për arsye disiplinuese lejohet, me kusht që arsyet të jenë qartësisht dhe tërësisht të përshkruara në ligj.”

8 Fletë votimi të kontestuara janë ato fletë, vlefshmëria ose vlerësimi i të cilave kundërshtohet nga anëtarët e Grupeve të Numërimit ose vëzhguesit (Neni 118 i Kodit Zgjedhor).

zbatoi të njëjtat pragje të përcaktuara për zgjedhjet parlamentare.⁹ Mandatet e këshillave vendore iu shpërndanë partive dhe koalicioneve sipas sistemit d'Hondt. U krye edhe një ndarje e dytë duke përdorur metodën Sainte-Laguë për t'ua shpërndarë vendet partive brenda koalicionit.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet vendore të vitit 2011 u administruan nga një administratë zgjedhore prej tre nivelesh, që përbëhej prej KQZ-së, 66 KZAZ-ve dhe 4,882 Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi i votave u krye në 66 VNV, të cilat punonin nën autoritetin e KZAZ-së përkatëse.

A. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KQZ-ja është një organ i përhershëm, shtatë anëtarët e të cilit zgjidhen nga Kuvendi për një mandat katër-vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Formula për përbërjen e KQZ-së pasqyron përfaqësimin parlamentar, me katër anëtarë të emëruar nga partitë e shumicës (anëtarë të propozuar nga shumica) dhe tre nga opozita (anëtarë të propozuar nga pakica). KQZ-ja aktuale u zgjodh në shkurt 2009.¹⁰ Përveç kësaj, të gjitha partitë që garonin në zgjedhjet vendore kishin të drejtën të emëronin përfaqësues në KQZ. Këta përfaqësues mund të merrnin pjesë në diskutime dhe të paraqisnin propozime, por nuk kishin të drejtën e votës.

Përgjegjësitë e KQZ-së përfshinin emërimin dhe heqjen e anëtarëve të KZAZ-ve, mbikëqyrjen e përgatitjeve për zgjedhjet, printimin e fletëve të votimit, trajnimin e zyrtarëve të zgjedhjeve të niveleve më të ulta, mbikëqyrjen e masave të financimit të fushatës, vendosjen e sanksioneve për shkeljet administrative të lidhura me zgjedhjet, shqyrtimin e ankesave dhe ankimeve, shpalljen e kandidatëve fitues për anëtarë të këshillave vendore, dhe nxjerrjen e tabelës së rezultateve zgjedhore për kryetarin dhe këshillin e bashkisë së Tiranës.

Gjatë periudhës zgjedhore, Kodi Zgjedhor parashikon që KQZ-ja të mblidhet çdo ditë në seanca publike. Vendimet merren me votën e shumicës, d.m.th. katër nga shtatë anëtarët. Megjithatë, një shumicë e cilësuar prej pesë votash nevojitet për disa lloje vendimesh si miratimi i strukturës organizative të KQZ-së dhe rregullorja e tij e procedurave; propozimet për largimin e anëtarëve të KQZ-së; miratimi i udhëzimeve; përvijimi i Zonave të Administrimit Zgjedhor (ZAZ); përcaktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore; pranimi i ankesave kundër tabelës përmbledhëse të rezultateve për një ZAZ; pavlefshmëria e zgjedhjeve në një QV; dhe pavlefshmëria dhe përsëritja e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore ose në të gjithë vendin. Një shumicë e cilësuar nevojitet edhe për nxjerrjen e rregullave që konsiderohen "akte të natyrës normative".

Në përputhje me përgjegjësitë e saj, KQZ-ja përgatiti një fushatë për informimin e votuesve e shfaqur në median audiovizive dhe të shkruar. Faza e parë promovonte pjesëmarrjen e votuesve të rinj dhe trajtonte problemin e votimit familjar. Faza e dytë shpjegonte procedurën e votimit. Sipas KQZ-së, materialet e informimit të votuesit ishin përgatitur edhe në gjuhën greke dhe maqedonase. Një spot i KQZ-së që nxiste votimin përfshinte pyetje mbi çështje politike dhe u kritikua nga PS-ja, e cila pretendonte se spoti ishte i ngjashëm me një reklamë politike të Z. Basha, kandidati i PD-së për kryetar bashkie të Tiranës.

9 Kodi Zgjedhor përcakton një prag tre dhe pesë për qind për partitë dhe koalicionet përkatësisht, për t'u pranuar të marrin pjesë në ndarjen e mandateve në një zonë zgjedhore për zgjedhjet parlamentare.

10 Kryetari dhe dy anëtarë u emëruan nga partia më e madhe e shumicës (PD). Nën kryetari dhe një tjetër anëtar u emëruan nga partia më e madhe e opozitës (PS). Dy anëtarët e tjerë u emëruan nga Partia Republikane (PR) dhe Partia Social Demokrate (PSD) përkatësisht të shumicës dhe opozitës parlamentare.

B. KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE

Ka nga një KZAZ për secilën prej 66 ZAZ-ve.¹¹ KZAZ-të i cakton KQZ-ja dhe përbëhen prej shtatë anëtarësh, përfshirë kryetarin dhe nënkryetarin, të ndihmuar nga një sekretar. Formula e emërimit për KZAZ-në pasqyron atë të KQZ-së, me përjashtimin se në gjysmën e KZAZ-ve kryetari emërohet nga partia më e madhe e shumicës ndërsa në gjysmën tjetër nga partia më e madhe e opozitës. Kriteret për të përcaktuar partinë që do të përbënte shumicën në secilën KZAZ u rregulluan me vendim të KQZ-së, sipas të cilit PD-ja do të emëronte kryetarin në KZAZ-të me numër tek dhe PS-ja në KZAZ-të me numër çift. Nënkryetari dhe sekretari u përkisnin partisë më të madhe që nuk mbante kryesimin e KZAZ-së përkatëse. Vendimet e KZAZ-së merren me votë shumice.

KZAZ-të ishin përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ-në nën mbikëqyrjen e tyre. Këtu përfshihej regjistrimi i partive, koalicioneve dhe kandidatëve për çdo NjQV; shpërndarja e materialeve të votimit pranë KQV-ve; dhe përgatitja dhe miratimi i tabelës përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve për çdo NjQV. Përveç këtyre, KZAZ-të shpallnin kandidatin fitues për kryetar bashkie dhe komune.¹²

C. KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT DHE GRUPET E NUMËRIMIT

KQV-të u ngritën prej KZAZ-ve sipas së njëjtës formulë anëtarësimi që u ndoq për KZAZ-të, përfshirë shpërndarjen e pozicioneve të kryetarit dhe nënkryetarit. KQV-të ishin përgjegjëse për organizimin e votimit në QV-të gjatë ditës së zgjedhjeve. Në përfundim të votimit, fletët e votimit dhe materialet e tjera zgjedhore paketohen në mënyrë të sigurtë dhe transportohen prej KQV-ve të shoqëruara nga policia drejt VNV-së përkatëse.

Numërimi u zhvillua në 66 VNV, një për çdo ZAZ. Çdo VNV kishte pesë deri në dhjetë tavolina numërimi me dy Grupe të Numërimit të Votave, të cilët punonin në turne. Grupet e numërimit përbëheshin nga katër anëtarë, dy nga partitë qeverisëse (PD dhe LSI) dhe dy nga opozita (PS). Ndonëse anëtarët duhet të përfaqësojnë katër parti, vetëm tre prej tyre i plotësonin kërkesat e pragut sipas përbërjes aktuale të parlamentit, ku PS-ja ishte e vetmja parti e opozitës me të paktën dy mandate.¹³ Kodi Zgjedhor nuk parashikon situatën kur vetëm një parti e opozitës ka të paktën dy mandate në zgjedhjet parlamentare pararendëse, dhe KQZ-ja vendosi njëzëri që anëtari i katërt i grupeve të numërimit të propozohet nga PS-ja për të plotësuar këtë boshllëk ligjor.

KQZ-ja caktoi 24 inspektorë, 2 për secilin prej 12 qarqeve, për të koordinuar punën me KZAZ-të. Mes detyrave të tjera, inspektorët u transmetonin KZAZ-ve vendimet e KQZ-së dhe anasjelltas, organizonin trajnimin e anëtarëve të KZAZ-së dhe KQV-së dhe mbështetnin KZAZ-të në përgatitjen e zgjedhjeve.

Çdo subjekt zgjedhor (parti politike, koalicion, kandidat i propozuar nga një grup zgjedhësish dhe kandidatët për kryetar) ka të drejtën të caktojë vëzhgues pranë KZAZ-ve, KQV-ve dhe për çdo

11 Juridiksioni territorial i një ZAZ-je është, si rregull, i njëjtë me rrethin territorial administrativ. Për zgjedhjet vendore, një ZAZ mund të përfshijë një ose më shumë NjQV.

12 Përveç Tiranës, kur KQZ-ja përgatit tabelën përmbledhëse të rezultateve dhe shpall kandidatin fitues për kryetar bashkie dhe kandidatët fitues për këshillin e qytetit (Neni 122.6 i Kodit Zgjedhor).

13 Anëtari i parë dhe i dytë i grupit të numërimit propozohen nga partia së cilës i përket kryetari dhe nënkryetari i KZAZ-së. Anëtari i tretë dhe i katërt i grupit të numërimit propozohet përkatësisht nga partitë e shumicës parlamentare dhe opozitës parlamentare (me përjashtim të atyre partive që kanë propozuar anëtarin e parë dhe të dytë), me kusht që të kenë fituar të paktën dy mandate në zgjedhjet parlamentare pararendëse (Neni 95 dhe 96 i Kodit Zgjedhor).

tavolinë numërimi në një VNV. Për partitë që formojnë koalicion, e drejta për të caktuar vëzhgues i takon koalicionit dhe jo partive. Kandidatët lejohen të jenë të pranishëm gjatë numërimit të votave, sikurse e parashikon Kodi Zgjedhor.

D. VLERËSIMI I ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE NË PERIUdhËN PARAZGJEDHORE

KQZ-ja i përfundoi përgatitjet komplekse teknike për zgjedhjet përgjithësisht në një mënyrë transparente. Megjithatë, klima e përgjithshme politike influencoi punën dhe kolegjalitetin e KQZ-së, siç bënë edhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme lidhur me faktin nëse disa vendime mund të merreshin me shumicë të thjeshtë apo kërkonin shumicë të cilësuar prej pesë votash. Afate e ngushta kohore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor ndikuan në lindjen e disa problemeve në ditën e zgjedhjeve, përfshirë anulimin ose anulimin e pjesshëm të zgjedhjeve në katër NjQV për shkak të fletëve të votimit me gabime shtypi ose të shpërndara gabimisht.

Seancat e KQZ-së ishin publike dhe transmetoheshin drejtpërdrejt në faqen e saj të internetit. Seancat u mbuluan gjerësisht nga media. Rendi i ditës së seancave nuk u shpall gjithmonë 24 orë më parë, sikurse e parashikon ligji. Anëtarët e KQZ-së të emëruar nga opozita dhe një përfaqësues i PS-së deklaruan se nuk e merrnin gjithmonë dokumentacionin për diskutim në kohë të mjaftueshme përpara seancave. Në disa raste, kryetari i KQZ-së i trajtoi këto shqetësime duke e shtyrë diskutimin për në seancën e radhës. Shumica e vendimeve të KQZ-së u botuan në faqen e internetit, ndonëse shpesh disa ditë pas miratimit.¹⁴

Tre anëtarët e emëruar nga opozita e ndërprejnë pjesëmarrjen në seancat e KQZ-së nga 12 janari deri më 8 prill, për shkak të mosmarrëveshjeve me anëtarët e shumicës lidhur me miratimin e disa vendimeve me shumicë të thjeshtë në vend të miratimit me shumicë të cilësuar dhe lidhur me rregulloren e brendshme të KQZ-së për procedurat. Mungesa e këtyre anëtarëve shkaktoi vonesa dhe probleme në përgatitjen e zgjedhjeve.

Pasi KQZ-ja nisi të mblidhej përsëri me përbërje të plotë, ajo nuk tentoi t'i zgjidhte këto çështje dhe puna e saj vazhdoi të ndikohej nga një klimë politike tejet e polarizuar. Në veçanti, çështja nëse një vendim duhet të merrej me shumicë të cilësuar apo jo mbeti një temë e shpeshtë diskutimi në seancat e KQZ-së. Diskutimet shpesh ishin të ashpra dhe me natyrë politike dhe ndonjëherë shkuan deri në sulme dhe akuza personale. Përveç këtyre, mbledhjet e KQZ-së shpesh u përdorën si sheshbetejë politike prej përfaqësuesve të PD-së dhe PS-së.

KQZ-ja votoi në mënyrë partizane (katër anëtarë të propozuar nga shumica kundër tre anëtarëve të propozuar nga opozita) lidhur me çështjet e debatuar mes PD-së dhe PS-së. Kjo u pa veçanërisht në rolin e KQZ-së si organ rregullues i medias (shih rubrikën për Median), por atmosfera partizane ia vështirësoi punën KQZ-së të trajtonte edhe disa çështje teknike në mënyrë kolegjinale. Këto çështje përfshinin përmbajtjen e fletëve të votimit, vendndodhjen e QV-ve në ambiente private dhe prodhimin e vulave rezervë për KQV-të. Vendimet për të gjitha këto çështje u apeluan pranë Kolegjit Zgjedhor, dhe disa prej tyre u rrëzuan më vonë. KQZ-ja gjithashtu mori shpesh vendime unanime, por vetëm për çështjet që nuk debatoheshin mes PD-së dhe PS-së, ose për të cilat këto parti kishin arritur marrëveshje, si masat shtesë të sigurisë për fletët e votimit, rendi i numërimit të kutive të votimit në Tiranë, përbërja e grupeve të numërimit, udhëzimet për numërimit e votave dhe manualët për procedurat e votimit dhe numërimit.

Çështjet e tjera potencialisht përçarëse nuk u trajtuan fare nga KQZ-ja. Këtu u përfshi çështja e

14 Neni 24.3 i Kodit Zgjedhor thotë se vendimet e KQZ-së duhet të botohen menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së.

fletëve të votimit të hedhura në kutinë e gabuar, çka në rastin e garës për kryetar bashkie të Tiranës u bë faktori vendimtar në nxjerrjen e rezultatit (shih rubrikën Votimi dhe Numërimi). Për më tepër, përveç ndryshimit të një udhëzimi të vitit 2009 mbi procedurat e numërimit, KQZ-ja nuk miratoi asnjë udhëzim për të trajtuar specifikat e zgjedhjeve vendore, si regjistrimin e koalicioneve, partive dhe kandidatëve për garat e Tiranës, financimin e fushatës dhe rregullimin e medias.

Në pjesën më të madhe, anësia në KQZ nuk u shtri deri në komisionet e nivelit më të ulët. Shumica e KZAZ-ve duket se punuan në mënyre profesionale dhe kolegiale, pa probleme të mëdha në periudhën parazgjedhore. Megjithatë, jo të gjitha KZAZ-të zhvilluan mbledhje të rregullta dhe nuk zbatuan orarin e punës të rekomanduar nga KQZ-ja. KZAZ-të arritën të përmbushnin detyrat pavarësisht zëvendësimit të vazhdueshëm të anëtarëve të KZAZ-së me kërkesë të partive që emëronin anëtarët, çka vazhdoi deri në ditën e zgjedhjeve dhe pas saj.¹⁵

KZAZ-të duhet të ishin ngritur tre muaj përpara ditës së zgjedhjeve, por partitë nuk i dorëzuan propozimet brenda afatit ligjor. Ndonëse partitë e shumicës i emëruan anëtarët e tyre pak pas afatit, partitë e opozitës nuk e bënë këtë gjë, duke e lënë gjysmën e KZAZ-ve pa kuorum. Duke qenë se kjo situatë nuk parashikohet nga Kodi Zgjedhor, KQZ-ja ishte e detyruar të gjente një zgjidhje për të siguruar që zgjedhjet të zhvilloheshin në kohën e parashikuar, një detyrë që u vështirësua edhe më tepër nga bojkoti i anëtarëve të KQZ-së të emëruar nga opozita. KQZ-ja mori një vendim për të emëruar komisionerë nga shoqëria civile, duke u mundësuar KZAZ-ve ndërmarrjen e hapave të rëndësishme të procesit zgjedhor si regjistrimi i kandidatëve. Nga fundi i marsit, të gjitha partitë dorëzuan emrat dhe u bë e mundur emërimi i anëtarëve të KZAZ-ve në përputhje me Kodin Zgjedhor. KQZ-ja pranoi dorëheqjen e të emëruarve nga shoqëria civile, të cilët ishin caktuar në KZAZ-të.

KQZ-ja dhe KZAZ-të shkelën mjaft afate kohorë të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor. Megjithatë, kjo erdhi shpesh si pasojë e mospërmbushjes së detyrave dhe përgjegjësiave ligjore nga ana e partive. Këto vonesa e vunë në vështirësi administrimin e zgjedhjeve dhe ndikuan në uniformitetin e procesit. Partitë politike e vonuan caktimin e KQV-ve dhe anëtarëve të grupeve të numërimit, dhe shpesh kishte ndryshime të minutës së fundit pas caktimit të tyre.¹⁶ Prandaj, jo të gjithë anëtarët e KQV-ve dhe grupeve të numërimit arritën të trajtoheshin në kohë nga KQZ-ja, çka mund të ketë ndikuar në zhvillimin e votimit dhe të numërimit. Përveç këtyre, KQZ-ja miratoi manualët për procedurat e votimit dhe numërimit vetëm një javë përpara ditës së zgjedhjeve. Përzgjedhja e partive me të drejtën për të emëruar anëtarë të grupeve të numërimit u bë më 18 prill, dhe jo më 8 prill.¹⁷ Caktimi i vendndodhjes së VNV-ve u përfundua më 19 prill, 11 ditë pas afatit.

Së fundi, katër NjQV morën fletë të gabuara votimi ose fletë votimi me gabime. Sipas Kryetarit të KQZ-së, këto probleme ndodhën kryesisht për shkak të afateve kohore të ngushta të specifikuara në Kodin Zgjedhor për emërimin e kandidatëve dhe për ankimimet lidhur me rrëzimin e kandidaturës dhe përmbajtjen e fletës së votimit. Kjo gjë shkaktoi më pas miratimin dhe printimin me vonesë të fletëve të votimit.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

-
- 15 Deri më 16 maj, ishin zëvendësuar 140 nga 528 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve (42 nga PD-ja dhe 42 nga PS-ja, 38 nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) dhe 18 nga LSI-ja).
- 16 MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri re se në 27 KZAZ, partitë nuk i kishin emëruar anëtarët e grupeve të numërimit sipas afatit deri më 4 maj. Disa anëtarë u emëruan edhe pasi kishte nisur numërimi.
- 17 Neni 96.2 i Kodit Zgjedhor parashikon që KQZ-ja të hedhë short mes partive që kanë të drejtën të propozojnë emra për anëtarë të grupeve të numërimit jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve.

Të gjithë shtetasit shqiptarë 18 vjeç e lart kanë të drejtë të votojnë, përveç atyre të shpallur nga gjykata si të paafte mendërisht. Zgjedhësit mund të votojnë vetëm vetë (personalisht) në një qendër votimi në Shqipëri; nuk ka dispozita për votimin jashtë vendit, votimin me postë ose votimin në QV lëvizëse. QV të veçanta mund të ngrihen në spitale, burgje dhe qendra të paraburgimit.

Shqipëria ka një sistem pasiv të regjistrimit të zgjedhësve. Listat e zgjedhësve nxirren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, që mbahet nga Ministria e Brendshme (MB). Kjo bazë të dhënash bazohet në informacionin nga Zyrat e Gjendjes Civile (ZGjC) që janë pjesë e administratës vendore. ZGjC-të janë përgjegjëse për hartimin dhe saktësinë e regjistrimit civil për territorin e NjQV-së, nën autoritetin e kryetarit përkatës së bashkisë ose komunës së NjQV-së. Sipas KQZ-së, numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar ishte 3,166,279 për zgjedhjet vendore 2011.

Hartimi i listave të zgjedhësve nisi në tetor 2010, me krijimin nga ZGjC-të të Listave Paraprake të Zgjedhësve për çdo zonë të QV. Listat Paraprake u afishuan për publikun në 26 tetor 2010. Zgjedhësit mund të kërkonin ndryshime të të dhënave të tyre në Listat Paraprake deri në 60 ditë para ditës së zgjedhjeve, dhe në disa raste, ndryshimet mund t'i kërkonin anëtarët e familjes ose palë të treta, ose t'i bënte direkt kryetari i bashkisë nëse një individ ishte regjistruar në më shumë se një listë ose nuk ishte shtetas shqiptar.

Me ligj, tre versione të printuara të Listave Përfundimtare të Zgjedhësve (LPZ) duhet të firmosen prej kryetarëve të NjQV-ve dhe t'u dërgohen KZAZ-ve një muaj para ditës së zgjedhjeve. Për këto zgjedhje vendore, MB-ja nxori një udhëzim për ZGjC-të që të printonin LPZ-të më 5 prill 2011 për çdo zonë të QV nën juridiksionin e tyre. Shumica e KZAZ-ve i morën LPZ-të brenda afatit ligjor të datës 8 prill.¹⁸ Kopjet elektronike iu vunë në dispozicion partive sipas kërkesës, çka e shtoi transparencën.

KZAZ-të duhet t'i afishojnë LPZ-të për publikun në çdo QV. Zgjedhësit që nuk e gjejnë emrin në LPZ mund të votojnë nëqoftëse marrin një vendim gjykate që certifikon vendbanimin e tyre. Ndërsa LPZ-të zakonisht afishoheshin në QV, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri re raste në të cilat lista nuk ishte afishuar ose zgjedhësit nuk kishin akses.¹⁹

MB-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme që nga zgjedhjet parlamentare 2009 për të hequr regjistrimet e shumëfishta dhe personat e vdekur nga të dhënat e regjistrimit civil. Gjatë një verifikimi të kryer në tetor-nëntor 2010, u gjetën afro 39,000 të dhëna të shumëfishta që u korresponduan rreth 19,000 shtetasve. Pas kontrolleve të bëra në të gjitha ZGjC-të, të dhënat e shumëfishta u reduktuan në 1,600. Sipas MB-së, të dhënat e dubluara të shumëfishta mund të fshiheshin nga ZGjC-të pasi të kishin konfirmuar se cilat ishin të dhënat aktuale.

Pavarësisht këtij progresi, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti një numër çështjesh lidhur me LPZ-të. Një mospërputhje prej 1,420 zgjedhësish u vërejt ndërmjet numrit të përgjithshëm të zgjedhësve në LPZ-të që përdorte KQZ-ja, që vinin nga KZAZ-të, dhe numrit të dhënë nga MB-ja më 9 prill, që bazohej në bazën e të dhënave të regjistrimit civil. Sipas MB-së kjo ishte shkaktuar prej ZGjC-ve dhe kryetarëve të bashkive dhe komunave që jo gjithmonë zbatonin procedura uniforme të dorëzimit të LPZ-ve pranë KZAZ-ve, sidomos kur printonin LPZ-të përpara datës së udhëzuar. Për më tepër, kontrollet e rastit në LPZ-në elektronike që bëri MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it treguan se më shumë se 1,200 zgjedhës të përfshirë në LPZ-të në rang vendi nuk ishin caktuar në asnjë QV.

18 Nga 66 KZAZ, 62 deklaruan se i kishin marrë LPZ-të për të gjitha NjQV-të e tyre brenda afatit. Tre nga katër KZAZ-të e mbetura (KZAZ-të 19, 57 dhe 61) i morën një ditë me vonësë. Në dy komuna të KZAZ-së 4, Vendreshe dhe Bogove, kryetarët e NjQV-ve nuk pranuan të firmosin LPZ-të.

19 Sikurse u vu re në QV 0664 (rrethi i Kukësit) dhe disa QV të tjera në minibashkitë e Tiranës (KZAZ-të 47, 48, 51, 52, 53 dhe 54).

Meqë LPZ-të printohen në bazë QV-je, kjo do të thotë se këta zgjedhës nuk shfaqeshin në listën e zgjedhësve në asnjë QV, çka mund të rezultonte në heqjen e të drejtës për të votuar të këtyre zgjedhësve.

Afërsisht 40 përqind e votuesve në rang vendi nuk e kishin kodin e veçantë të banesës në LPZ.²⁰ Autoritetet vendore dhe MB-ja informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se këta ishin kryesisht shtetas me banim jashtë vendit, ose persona që banonin në godine pa adresë zyrtare, ose persona të cilëve nuk u dihej adresa. Numri i zgjedhësve të regjistruar pa një kod të veçantë banimi varionte në vend, por më i larti ishte në qytetin e Vlorës (54 përqind), Durrësit (51 përqind), dhe bashkinë e Prrenjasit në rajonin e Elbasanit (55 përqind). Numri i lartë i zgjedhësve me adresë të panjohur e ul saktësinë e listave të zgjedhësve. Kjo çështje vijon që prej zgjedhjeve të kaluara.

Kodi Zgjedhor nuk e përcakton qartë afatin për t'i bërë ndryshimet LPZ-ve. Sipas MB-së, LPZ-ja duhet të pasqyrojë të gjitha ndryshimet në statusin e shtetasve deri në momentin që LPZ-të printohen (më 5 prill). Sipas interpretimit të PS-së, ndryshimet në listat e zgjedhësve mund të kërkohen vetëm deri 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Prandaj, sipas argumentit të tyre, LPZ-të duhet vetëm të pasqyrojnë ndryshimet e bëra deri më 8 mars.²¹ MB-ja argumentoi se afati prej 60 ditësh u referohej vetëm ndryshimeve të bëra me kërkesë të zgjedhësve dhe jo ndryshimeve në regjistrin civil prej të cilit ishin nxjerrë LPZ-të.

Gjatë muajit përpara shpalljes së LPZ-ve, PS-ja shprehu shqetësime se po shtoheshin zgjedhës në mënyrë të paligjshme në disa NjQV, përfshirë minibashkitë e Tiranës të kontrolluara nga PD-ja dhe LSI-ja, me qëllim që të ndryshohej ekuilibri i pushtetit politik në këto zona. PS-ja kërkoi që t'i vihehin në dispozicion përditësimet e rregullta të Listës Paraprake të Zgjedhësve, ku të pasqyroheshin ndryshimet e vazhdueshme në statusin e regjistrimit të zgjedhësve. Kjo kërkesë u refuzua prej MB-së, e cila u shpreh se Kodi Zgjedhor parashikonte që partitë të merrnin vetëm Listën Paraprake dhe Listën Përfundimtare të Zgjedhësve.

Pas shpalljes së LPZ-ve, PS-ja deklaroi se ajo kishte gjetur prova të zgjedhësve që ishin shtuar në regjistrin civil në mënyrë të paligjshme dhe bëri kallëzime në prokurori. Disa zyrtarë të PS-së bënë deklarata publike se mund të ngrihej padi penale kundër këtyre zgjedhësve që do tentonin të votonin ditën e zgjedhjeve ose që persona të tillë do të pengoheshin të votonin. Ndërkohë që këto ngelën në kuadër të deklaratave, pretendimet shtuan tensionet në javën para datës së zgjedhjeve.

Me ligj, një QV duhet të ketë ndërmjet 150 dhe 1,000 zgjedhës të regjistruar. Në pothuaj të gjitha bashkitë kishte QV të cilat kishin më shumë se 1,000 zgjedhës, në disa raste deri në 2,000 zgjedhës, një problem i vjetër që është komentuar nga OSBE/ODIHR në zgjedhjet e kaluara. Në QV të tilla kishte mbipopullim dhe radhë të gjata të zgjedhësve në ditën e votimit.

VII. REGJISTRIMI I PARTIVE DHE KANDIDATËVE

Në zgjedhjet vendore mund të marrin pjesë kandidatë të emëruar nga partitë politike nga koalicionet e partive politike, ose kandidatë të pavarur të propozuar nga grupe zgjedhësish (subjekte zgjedhore). Partive politike dhe komiteteve iniciuese të grupeve të zgjedhësve që propozuan kandidatë në zgjedhjet vendore u ishte kërkuar të regjistroheshin në KQZ. Dy ose më

20 Të gjithë zgjedhësve u caktohet një kod banese në listat e votuesve. Nëse vendbanimi është i panjohur, shfaqet një kod i përgjithshëm si “888”, “999”, ose “000”.

21 Në nenin 52.1 të Kodit Zgjedhor thuhet se “kërkesat për ndryshime në Listën Paraprake të Zgjedhësve nuk mund të dorëzohen më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.”.

shumë parti që janë regjistruar si subjekte zgjedhore mund të regjistrohen në KQZ si koalicionë zgjedhore.

Subjektet zgjedhore duhet të dorëzonin pranë KZAZ-ve emrat e kandidatëve për kryetar ose listën shumë emërore të kandidatëve për këshill jo më vonë se 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Partitë pa përfaqësim në Kuvend ose në këshillin vendor përkatës duhet të dorëzonin një listë me nënshkrime të së paku 1 përqind të zgjedhësve të regjistruar në një zonë zgjedhore të caktuar për emërimin e kandidatëve për kryetar ose këshill. Ose, këto parti mund t'i bashkoheshin një koalicioni me njërin prej partive më të mëdha. Një grup zgjedhësish që ishin regjistruar pranë një KZAZ-je si subjekt zgjedhor duhet të siguronin një numër të ngjashëm nënshkrimesh, me përjashtim të rasteve kur kandidati i tyre ishte aktualisht kryetar bashkie a komune. Zgjedhësit duhet të dorëzonin nënshkrimet mbështetëse para KZAZ-së ose noterit. Kodi Zgjedhor vetëm i lejon zgjedhësit të firmosin në mbështetje të një partie ose kandidati.

Meqë Kodi Zgjedhor nuk e specifikon organin përgjegjës për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe këshill të Tiranës, këta kandidatë i regjistroi vetë KQZ-ja.

Regjistrimi i subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve ishte në përgjithësi gjithëpërfshirës. KQZ-ja regjistroi 56 parti si subjekte zgjedhore. Nga këto, 22 parti garuan në zgjedhje si pjesë e koalicionit të kryesuar nga PD-ja, Aleanca për Qytetarin dhe 23 parti garuan për koalicionin e kryesuar nga PS-ja, Aleanca për të Ardhmen. KQZ-ja refuzoi të regjistronte dy parti për shkak të dokumentacionit të paplotë të regjistrimit.

53 parti politike i dorëzuan listat e kandidatëve për zgjedhjet për këshill vendor. Sipas KQZ-së, kishte rreth 75 000 kandidatë për këshilla dhe 872 kandidatë për kryetar bashkie e komune. Nga këta, 62 kandidonin si të pavarur për zgjedhjet për këshill dhe 44 për kryetar.

KQZ-ja rishikoi rreth 50 vendime të KZAZ-ve lidhur me refuzimin e regjistrimit të kandidatit, prej të cilave 18 u rrëzuan. Në dy NjQV, KQZ-ja fillimisht nuk i kishte vënë në fletën e votimit partitë me listat e kandidatëve të regjistruar për shkak të gabimit të KZAZ-së. Në një rast, PBDNJ-ja apeloj në Kolegjin Zgjedhor dhe u vu në fletën e votimit të NjQV-së përkatëse. Në një rast tjetër, Partia e Tolerancës së Re (PTR) nuk apeloj.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet u zhvilluan në një mjedis politik tejet të polarizuar. Partitë e opozitës shprehën mosbesimin në autoritetet dhe administrimin e zgjedhjeve, ndërsa partitë në qeveri pretenduan se komisionerët e emëruar prej opozitës do të pengonin procesin. Disa kryetarë partie ngritën pretendimin se kundërshtarët e tyre ishin përfshirë në korrupsion ose ishin përgjegjës për ngjarjet e 21 janarit 2011.

Fushata zyrtare filloi më 8 prill, ndonëse partitë po promovoheshin në mënyrë aktive përpara kësaj date. Të gjithë kandidatët në përgjithësi patën mundësinë të bënin fushatë në mbarë vendin. Kryetarët e partive zhvilluan mitingje në mbarë Shqipërinë bashkë me kandidatët vendorë. Zyrat elektorale u ngritën në pjesën më të madhe të vendit dhe aktivitete lokale u zhvilluan në shkallë të gjerë, përfshirë takimet me grupe të vogla votuesish ose fushata derë më derë. Niveli i intensitetit të fushatës varionte, dhe në disa zona rurale, kishte dukshëm më pak aktivitete. Partitë kryesuese në dy blloqet zgjedhore, PD-ja dhe LSI-ja nga koalicioni Aleanca për Qytetarin dhe PS-ja nga koalicioni Aleanca për të Ardhmen, bënë fushatë më të gjerë. Disa parti të tjera të të dyja koalicioneve, si edhe PBDNJ-ja, e cila doli e vetme në këto zgjedhje, ishin mjaft aktive. Vëmendja

u përqëndrua më shumë te zgjedhjet për kryetar bashkie dhe komune sesa zgjedhjet për këshill, veçanërisht në garën për kryetar bashkie të Tiranës.

Kandidatët, veçanërisht ata të PD-së, theksuan çështjet vendore, përfshirë zhvillimin e infrastrukturës dhe cilësinë e shërbimeve të bashkisë. Në fushatë spikatën edhe çështje të tjera kombëtare, veçanërisht punësimi dhe taksat. Përveç çështjeve vendore, PS e përqendroi kritikën ndaj qeverisë qendrore. Reklammat e fushatës u përdorën gjerësisht prej partive më të mëdha përfshirë billboardet, posterat dhe reklammat në television. Disa reklama të PS-së përmban imazhe filmike të ngjarjeve të dhunshme të 21 janarit dhe sulmet e ashpra mbi kryeministrin.

Zyrtarët e shtetit, kryesisht Presidenti dhe Kryeministri bënë thirrje të përsëritura për një fushatë të qetë dhe paqësore. Megjithatë, u shënuan edhe një numër i madhe incidentesh të dhunshme të lidhura me zgjedhjet në disa qarqe, të cilat prishën atmosferën e fushatës.²² Ato përfshinë incidente jo fatale me armë ndaj një kandidati të PD-së më 1 prill dhe ndaj automjetit të kandidatit të PS-së për kryetar komune në Ishëm (qarku Durrës), më 2 maj, si edhe goditjen jo fatale me thikë të një mbështetësi të PS-së përpara një aktiviteti zgjedhor të PS-së në Tiranë më 12 prill. Pati një numër rastesh të vënies së eksplozivit dhe dëmtimit të pronës së kandidatëve dhe partive. Më 18 prill, një sasi eksplozivi shpërtheu jashtë apartamentit të kandidatit të PS për kryetar në minibashkinë 7, duke shkaktuar dëmtime të vogla. Më 5 maj, makina e kandidatit të PS-së për kryetar komune në Shtiqen (qarku Kukës) u dëmtua pas një shpërthimi. Më 19 prill, u tentua t'i vihej zjarri një zyre elektorale të PS-së në qytetin e Beratit. Më 28 prill, në Korçë u dëmtuan tre zyra të PS-së. Në një incident në rrethin e Matit (qarku Dibër), një mbështetës i PD-së u rrah keqas me pistoletë nga një aktivist i PS-së.

Gjatë fushatës u shënuan edhe disa raste kërcënimesh dhe goditjesh. Më 18 prill, në Sukth (qarku Durrës), një mbështetës i PS-së u rrah keqas ndërsa përpiquej të varte flamujt përpara një mitingu të PS-së. Më 21 prill, një person ndërpreu një aktivitet elektorale të PS-së në një lokal, dhe u pretendua se ai ishte duke kërcënuar disa prej pjesëmarrësve. Dy prej pjesëmarrësve e kishin informuar paraprakisht MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se i kishin kërcënuar ndërsa bënë fushatë në zonë. Në një prej incidenteve në Kamëz (qarku Tiranë), një zënkë e dhunshme ndërmjet mbështetësve të PD-së dhe PS-së përpara një mitingu të PS-së më 17 prill rezultoi me plagosjen e një mbështetësi të PD-së. Incidente të tilla të dhunshme janë në kundërshtim me pikën 7.7 të Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagenit në vitin 1990.²³

Pati konflikte për vendosjen e posterave dhe flamujve në shumë zona, çka në disa raste çoi në heqjen e posterave ose flamujve dhe ndonjëherë edhe në konfrontime të dhunshme. Dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe një udhëzim i KQZ-së që rregullojnë përgjegjësinë e autoriteteve vendore për përcaktimin e vendeve për afishimin e materialeve të fushatës nuk u zbatuan në mënyrë të njëtrajtshme dhe në shumë vende nuk u zbatuan aspak. Në Tiranë pati debate mbi një urdher të bashkisë për të hequr të gjithë flamujt politikë të vendosur në vende të paautorizuara, si edhe mbi një çadër fushate që PS-ja kishte ngritur në qendër të qytetit.²⁴ Më 18 prill, në Sukth (qarku Durrës), një mbështetës i PS-së u rrah keqas ndërsa përpiquej të varte flamujt e partisë përpara një

22 Incidentet e dhunshme dominuan në rajone të Tiranës (qyteti i Tiranës dhe Kamëz), Durrës, Korçë, dhe Kukës.

23 Pika 7.7 parashikon që Shtetet pjesëmarrëse “do të garantojnë funksionimin e ligjit dhe politikave publike për të lejuar fushatën politike të zhvillohet në një atmosferë të drejtë dhe të lirë, në të cilën, veprimet administrative, dhuna apo kërcënimi të mos ndalojnë kandidatët të shprehin lirshëm pikëpamjet dhe cilësitë e tyre, të pengojnë votuesit t’i mësojnë dhe diskutojnë ato apo të hedhin votën me frikën e hakmarrjes.”

24 Më 4 prill, Kreu i Inspektoriatit Ndërtimor të Bashkisë së Tiranës, i cili nxorri urdhrin për heqjen e flamujve u qëllua dhe u plagos, por nuk u bë e mundur të konfirmohej nëse ky incident ishte i lidhur me zgjedhjet.

mitingu të PS-së. Pati edhe të shtëna dhe u arrestua një aktivist i PD-së për kanosje, huliganizëm dhe prishje të rendit publik.

Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it iu raportuan një sërë ankesash në shumë qarqe të vendit se ndaj administratës shtetërore, përfshirë mësuesit, punonjësit e shëndetësisë dhe nëpunësit civilë si edhe nxënësit, po ushtrohej presion ose për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës të PD-së, ose për të mos shkuar në aktivitetet e opozitës. Presione të tilla përfshinin kërcënime për humbjen e vendit të punës ose nota të ulëta për nxënësit. MVZ-ja e OSBE/ODIHR i vlerësoi si të besueshme mjaft raste në qarkun e Tiranës, Kukësit, Elbasanit, Vlorës dhe Korçës. Për shembull:

- Mësuesit në Vlorë dhe Kamëz (qarku Tiranë) i urdhëroi drejtori i shkollës të merrnin pjesë në mitingjet e PD-së.
- Nxënësve të shkollës në Kukës dhe studentëve të universitetit në Korçë u thanë mësuesit të merrnin pjesë në një miting të PD-së.
- Personelit të spitalit në qarkun e Elbasanit iu kërkua të merrnin pjesë në një miting të PD-së.
- Nëpunësve civilë në një ministri në Tiranë iu kërkua nga Zyra përkatëse e Burimeve Njerëzore të merrnin pjesë në mitingjet e PD-së dhe pjesëmarrja e tyre u kontrollua.

Përveç këtyre, si PD-ja edhe PS-ja pretenduan se punonjësve të sektorit publik iu kërkohet të jepnin të dhënat personale të tyre dhe të familjarëve të tyre dhe në disa raste edhe të dhëna lidhur me vendin e votimit, si formë presioni. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it verifikoi disa raste në qarkun e Elbasanit dhe Tiranës.

Në një mbledhje të Këshillit të Ministrave më 29 prill, Kryeministri pranoi rastet e presioneve të tilla. Ai u bëri thirrje institucioneve publike të mos u bënin presion punonjësve dhe i siguroi nëpunësit shtetërorë se ishin të lirë të merrnin pjesë në aktivitetet politike dhe të votonin për partinë që dëshironin.²⁵

Përdorimi i burimeve administrative në nivel qendror apo vendor ndalohej me ligj. Në çelje të fushatës, Kryeministri nxori një udhëzim ku u kërkohet zyrtarëve shtetërorë dhe vendorë të siguroheshin që burimet administrative, në veçanti automjetet të mos përdorëshin për të bërë fushatë. U duk sikur kjo pati gjërësisht efekt, pasi pak raste të përdorimit të burimeve administrative u sollën në vëmendje të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it. Kjo përfaqëson një përmirësim.

Megjithatë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti një numër të kufizuar rastesh ku zyrtarë të qeverisë dhe kryetarët aktualë të bashkive dhe komunave që rikandidojnë përdorën aktivitetet zyrtare për qëllime fushate, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.²⁶ Këto raste përfshinin fjalime fushate gjatë inaugurimeve të infrastrukturës ose projekteve të tjera të financuara nga shteti nga ana e Kryeministrit dhe e disa kryetarëve të bashkive dhe komunave, përfshirë kryetarin e bashkisë së Tiranës. Për më tepër, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti se faqja elektronike zyrtare e Këshillit të Ministrave përmbante kalendarin e aktiviteteve zgjedhore dhe fjalimet elektorale të kryeministrit; dhe faqet elektronike zyrtare të bashkisë së Tiranës dhe Durrësit përmbanin informacion për

25 Njoftim për shtyp i datës 29 prill 2011, www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=14740.

26 Pika 5.4 i Dokumentit të OSBE-së në Kopenhagen i detyron Shtetet pjesëmarrëse të ruajnë “një ndarje të qartë ndërmjet Shtetit dhe partive politike”.

aktivitetet të zgjedhor të kryetarëve aktualë që rikandidojnë. U vërejtën edhe raste ku flamujt e partisë vareshin në ndërtesat zyrtare të nivelit vendor, për shembull në Kukës.

A. FINANCAT E FUSHATËS

Kodi Zgjedhor rregullon financimin e fushatës zgjedhore nëpërmjet fondeve publike dhe jopublike (private). Për më tepër, Ligji mbi Partitë Politike përmban rregulla mbi financimin e rregullt të partive politike. Ky ligj u ndryshua në shkurt 2011 për të ofruar dispozita më shumë të detajuara mbi financimin e partive dhe për të trajtuar shumicën e rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Europës kundër Korrupsionit (GRECO).²⁷

Partive politike u shpërndahen fonde si për aktivitetet e rregullta, sipas Ligjit mbi Partitë Politike,²⁸ edhe për aktivitetet e fushatës, sipas Kodit Zgjedhor. 50 përqind e fondeve publike për fushatë u jepen partive parlamentare në proporcion me numrin e vendeve në Kuvend. Dhe 50 përqindsh u shpërndahet partive me të paktën dy vende në Kuvend, në proporcion me numrin e përgjithshëm të votave që kanë marrë në zgjedhjet e mëparshme parlamentare. Në përputhje me këto rregulla, KQZ-ja shpërndau 65 milion lek (afërsisht 450 000 EUR) mes partive parlamentare që merrnin pjesë në zgjedhjet vendore 2011. Nga kjo shumë, më tepër se 60 milion lek u shpërndanë PD-së dhe PS-së.

Efekti i këtyre dispozitave bën që partitë jo parlamentare që garojnë në zgjedhje, sidomos ato që kanë përfaqësim në nivel vendor, të mbeten tërësisht të pafavorizuara në krahasim me partitë parlamentare dhe veçanërisht me dy partitë më të mëdha. Kjo bie në kundërshtim me praktikën e mirë të financimit të partive politike.²⁹ Këto dispozita duket se nuk janë të përshtatshme për zgjedhjet vendore, pasi partitë që nuk kanë përfaqësim në Kuvend mund të arrijnë gjithsesi të përfaqësohen në disa NjQV.

Subjektet zgjedhore mund të përfitojnë fonde për fushatat e tyre nga individë ose persona juridikë. Shuma maksimale që mund të japë një donator, qoftë në njësi monetare, qoftë në natyrë është 1 milion lek (afro 7 000 EUR). Në përputhje me Kushtetutën,³⁰ Kodi Zgjedhor kërkon që gjithmonë të bëhet publike lista e personave që bëjnë dhurime prej më shumë se 100 000 lekësh (rreth 700 EUR), dhe shuma e dhuruar. Kodi Zgjedhor nuk parashikon ndonjë afat se kur subjektet zgjedhore duhet të dorëzojnë listën e dhuruesve, ndërsa KQZ-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se ky informacion mund të sigurohej vetëm pas zgjedhjeve, pra nuk ofrohet transparencë e dhurimeve gjatë periudhës parazgjedhore.

27 Shih Raportin e GRECO-s për Vlerësimin e Shqipërisë mbi Transparencën e Financimit të Partive (15 maj 2009) dhe “Raportin mbi Përputhshmërinë e Shqipërisë” nxjerrë më 1 prill 2011, të disponueshëm në www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round3/ReportsRound3_en.asp.

28 Ligji mbi Partitë Politike i ndan 70 përqind të fondeve të rregullta publike për partitë, mes partive parlamentare në proporcion me vendet të tyre në Kuvend; 20 përqind në mënyrë të barabartë mes partive parlamentare; dhe 10 përqind mes partive që morën më shumë se 1 përqind të votave në zgjedhje pararendëse parlamentare. Shteti siguron ambiente për selitë dhe zyra vendore për partitë parlamentare të cilat kanë marrë mesatarisht më shumë se 1 përqind të votave gjatë tre zgjedhjeve të fundit parlamentare.

29 Shih “Udhëzuesin për Rregullimin e Partive Politike” CDL-AD(2010)024 të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, në Pikën 187 thuhet se, “formula për ndarjen e fondeve publike... duhet gjithashtu të parandalojë dy partitë më të mëdha politike nga monopolizimi i marrjes së fondeve publike.” Në Pikën 188 thuhet se: “për të promovuar pluralizmin politik, një pjesë e financimit duhet të shtrihet përtej atyre partive që përfaqësohen në Kuvend, me qëllim që të përfshihen të gjitha partitë që paraqesin kandidatë për zgjedhje dhe gëzojnë një nivel minimal të mbështetjes së qytetarëve.”

30 Në nenin 9.3 të Kushtetutës thuhet se “burimet e financimit të partive si edhe shpenzimet e tyre bëhen gjithmonë publike”.

Shpenzimet e përgjithshme të fushatës së një partie nuk mund të kalojnë më shumë se 10 herë shumën më të madhe që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për fushatë. Brenda 45 ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare, KQZ-ja cakton ekspertë kontabël për të audituar fondet e marra dhe të shpenzuara nga partitë gjatë fushatës. KQZ-ja mund të kryejë verifikime të raporteve të auditimit, por nuk është e detyruar ta bëjë këtë. Ajo duhet t'i botojë raportet e auditimit brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit, ose e verifikimit, nëse është kryer një i tillë. Partitë mund të gjobiten për mungesë të bashkëpunimit për auditim ose për tejkalim të kufirit të shpenzimeve. Refuzimi për të bërë transparent financimin e fushatës mund të ndëshkohet me një gjobë prej 2 milion lekësh (14 000 EUR) ose pezullim të financimit publik.

Mbeten disa çështje për t'u trajtuar. Së pari, Kodi Zgjedhor e lë në gjykim të KQZ-së verifikimin e raporteve të auditimit, por nuk parashikon kriteret për kryerjen e kontroleve të tilla. Ky shqetësim lidhur me Kodin Zgjedhor u ngrit paraprakisht në Opinion e Përbashkët 2009 të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias. Së dyti, KQZ-ja informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se audituesit nuk kontrollojnë tërësinë e llogarive të partive (d.m.th që të gjitha shpenzimet e lindura të fushatës të jenë të pasqyruar në dokumentacionin mbështetës). Pamundësia për të kontrolluar tërësinë e informacionit shton gjasat e dhurimeve të padeklaruara. Së fundi, KQZ-së nuk i janë shpërndarë burime të mjaftueshme për të ushtruar autoritetin e saj të zgjeruar dhe ende është e pafuqishme të kryejë funksionet mbikqyrëse në mënyrë të efektshme. Përveç mungesës së personelit për t'i kryer këto detyra, KQZ-ja ka fonde të kufizuara për të paguar audituesit e emëruar.

IX. MEDIA

A. MJEDISI MEDIATIK

Në Shqipëri funksionon një gamë e gjerë e operatorëve mediatikë, pavarësisht tregut të kufizuar të reklamave. Sipas të dhënave zyrtare, ekzistojnë tre stacione televizive me mbulim kombëtar (transmetuesi publik *TVSH*, *TV Klan* dhe *Top Channel*), 75 stacione televizive lokale dhe 70 stacione televizive kabllore.³¹ Tre stacione radiofonike transmetojnë në rang kombëtar dhe një sërë stacionesh të tjera radiofonike në nivel lokal. Televizioni dhe radioja janë burimet kryesore të informacionit. Ka afërsisht 30 gazeta kryesore dhe tri revista kryesore, megjithatë, lexueshmëria dhe tirazhi janë relativisht të ulta dhe të kufizuara në zonat urbane.³²

Pluraliteti dhe larmia e operatorëve mediatikë i lejoi votuesit të zgjidhnin mes një shumëllojshmërie pikëpamjesh në këto zgjedhje. Megjithatë, që të dyja, si media audiovizive, ashtu edhe ajo e shkruar u ndanë sipas linjave politike, duke rrezikuar pavarësinë e tyre.

B. KUADRI LIGJOR PËR MEDIAN

Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, duke e ndaluar haptas censurën. Në kundërshtim me praktikën e mirë,³³ shpifja dhe përhapja e sekreteve private mbeten shkelje penale. Ligjet e tjera që rregullojnë median janë Ligji për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat dhe Ligji për Shtypin. Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit është autoriteti rregullues dhe licencues i transmetuesve audiovizivë.

31 Sipas Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit, autoriteti i rregullimit dhe licencimit të medias.

32 Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias IREX 2010 raporton se 60 përqind e territorit të banuar në zonat rurale nuk janë të mbuluara nga media e shkruar: www.irex.org/system/files/EE_MSI_2010_Albania.pdf.

33 Deklarata e Përbashkët e Raportuesit Special të OKB-së për Lirinë e Mendimit dhe të Shprehjes, Përfaqësuesit të OSBE-së mbi Lirinë dhe Median dhe Raportuesit Special të OAS mbi Lirinë e Shprehjes, N. 190, dhjetor 2002, www.osce.org/fom/39838.

Nenet 77-85 të Kodit Zgjedhor përbëjnë një bazë gjithëpërfshirëse ligjore mbi mbulimin e periudhës zyrtare të fushatës nga ana e medias. Kodi Zgjedhor parashikon rregullat për kohën e transmetimit falas, mbulimin me lajme dhe reklamat e paguara; parashikon një periudhë të heshtjes zgjedhore; dhe ndalon botimin e sondazheve pesë ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Kodi Zgjedhor parashikon që partitë e mëdha politike të mbulohen me lajme në mënyrë të barabartë nga të gjitha mediat audiovizive dhe se kanë të drejtën të përfitojnë dyfishin e kohës së mbulimit të partive të vogla. Mbulimi me lajme i partive joparlamentare përcaktohet nga redaktorët, por nuk duhet ta tejkalojë kohën e transmetimit dhënë për partitë e vogla parlamentare.

Ligji gjithashtu parashikon kohë transmetimi falas në radion dhe televizionin publik në bazë të përfaqësimit të tyre në Kuvend. KQZ-ja, e cila është organi kryesor rregullator i medias gjatë periudhës zyrtare të fushatës, e udhëzoi transmetuesin publik t'u jepte 60 minuta kohë transmetimi falas partive të mëdha, 30 minuta partive të vogla parlamentare dhe 10 minuta secilës prej partive joparlamentare, që ishte regjistruar në zgjedhjet vendore.³⁴ Rendi i paraqitjes u vendos në një short publik më 7 prill.

Lejohen reklamat politike me pagesë në median audiovizive por ato janë të kufizuara në 90 minuta për partitë e mëdha politike, 45 minuta për partitë e vogla dhe 10 minuta për partitë joparlamentare. Kufijtë ligjorë të reklamave me pagesë bazuar në përfaqësimin në Kuvend janë në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit mes partive politike, sikurse parashikohet në angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare.³⁵

Më 28 mars, KQZ-ja krijoi Bordin e Monitorimit të Medias (BMM), organi këshillues përgjegjës për monitorimin e medias në përputhje me Kodin Zgjedhor. BMM-ja monitoroi 62 kanale televizive dhe 2 stacione radiofonike dhe ia dorëzonte çdo javë KQZ-së konstatimet dhe propozimet. Konstatimet mbi punën e BMM-së paraqiten në rubrikën e mëposhtme.

C. MONITORIMI I MEDIAS

Konstatimet e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it pas monitorimit të medias tregojnë se media ofroi një mbulim të gjerë të zgjedhjeve me lloje të ndryshme programesh.³⁶ Pesë kanalet televizive të monitoruara i kushtuan së bashku 258 orë çështjeve të lidhura me zgjedhjet, kryesisht gjatë edicioneve të lajmeve, programeve informative dhe debateve televizive. Gjatë fushatës zyrtare zgjedhore, transmetuesit planifikuan 35 debate televizive ndërmjet përfaqësuesve të partive dhe kandidatëve vendorë, ndonëse në 16 raste nuk u paraqit njëri ose që të dy kandidatët.³⁷ Transmetuesi publik *TVSH* e plotësoi detyrimin për t'u akorduar partive politike kohë televizive

34 Parti të mëdha politike janë ato me të paktën 20 përqind të mandateve në Kuvend (PD dhe PS). Parti të vogla janë ato me më pak se 20 përqind të mandateve në Kuvend (LSI, PR, Patia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) dhe PBDNJ).

35 Në pikën 7.8 të Dokumentit të Kopenhagenit 1990 thuhet se Shtetet pjesëmarrëse në OSBE do të "garantojnë që asnjë pengesë ligjore apo administrative të mos bllokojë aksesin e pakufizuar të medias, mbi baza jodskriminuese për të gjitha grupimet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor". Shih gjithashtu Rekomandimin e KE-së nr. R (99) 15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Masat lidhur me Mbulimin e Fushatave Zgjedhore nga Media.

36 MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi pesë kanale televizive (*TVSH*, *Top Channel*, *TV Klan*, *Vizion Plus* dhe *News 24*), çdo ditë nga ora 18:00 deri më 24:00, dhe katër gazeta të përditshme (*Shqip*, *Gazeta Shqiptare*, *Panorama* dhe 55).

37 Debate televizive ishin planifikuar për kryetarët e bashkive në Lushnjë, Lezhë, Burrel, Kamëz, Krujë, Gramsh, Rrogozhinë, Fier, Çorovodë, Kukës, Peshkopi, Kavajë, Vlorë, Gjirokastrë, Himarë, Elbasan dhe Durrës.

falas. Këto spote u transmetuan çdo ditë gjatë orarit me shikueshmëri më të lartë gjatë mbrëmjes. Transmetuesit respektuan dispozitat për heshtjen zgjedhore.

Media e monitoruar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ia kushtoi shumicën e mbulimit me lajme dy partive më të mëdha politike, PD-së dhe PS-së, ndërsa ofroi mesatarisht 11 përqind për të gjitha partitë e tjera politike.³⁸ Në këtë drejtim, asnjë operator nuk i respektoi dispozitat e Kodit Zgjedhor lidhur me partitë e vogla parlamentare, të cilat kanë të drejtën të përfitojnë gjysmën e kohës televizive kushtuar partive të mëdha.

TVSH-ja i kushtoi 42 përqind të lajmeve politike PD-së dhe 35 përqind PS-së, 3 përqind LSI-së, 2 përqind PDIU-së, 2 përqind PR-së dhe më pak se 1 përqind PBDNJ-së. Partitë joparlamentare përfituan 6 përqind të mbulimit me lajme. Një shtesë prej 10 përqind iu kushtua qeverisjes së kryesuar nga PD-ja. Toni i lajmeve ishte më shumë pozitiv për PD-në dhe disi më negativ për PS-në.

Pavarësisht ndarjes politike mes mediave, kanalet televizive private u ofruan votuesve një larmi pikëpamjesh. Monitorimi i medias tregoi se *TV Klan* favorizoi partitë në pushtet, ndërsa *Vizion Plus* favorizoi opozitën.³⁹ *Top Channel* dhe *News 24* kishin në përgjithësi tone neutrale ndaj dy partive më të mëdha, por në programet e lajmeve përdorën tone më negative ndaj qeverisë.⁴⁰

Dy vendime të KQZ-së lidhur me median shkaktuan shumë debate. Më 14 prill, me propozimin e BMM, KQZ-ja urdhëroi katër kanale private (*Vizion Plus*, *Top Channel*, *Ora News* dhe *News 24*) të ndërprisnin transmetimin e dy reklamave politike të PS-së me argumentin se partia politike nuk ishte qartësisht e dallueshme. KQZ-ja bazoi këtë vendim në nenin 84.4 të Kodit Zgjedhor, megjithëse ky nen nuk specifikon se si duhet të identifikohet një reklamë elektorale.⁴¹ Më 15 prill, KQZ-ja shtoi në një deklaratë për shtyp se sipas nenit 80.1.ç të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore duhet të ishin të përcaktuar qartë në reklamat e fushatës. Megjithatë, ky nen gjen zbatim vetëm për kohën falas të transmetimit në transmetuesit publikë, dhe jo për kohën e paguar në median private.

Për më tepër, BMM-ja e tejkaloj mandatin si një organ këshillimor dhe i paralajmëroi operatorët mediatike që të ndërprisnin spotet televizive, edhe përpara se KQZ-ja të merrte një vendim mbi këtë çështje. BMM-ja propozoi gjithashtu që të gjobiteshin ato media që nuk ndërprisnin spotet.⁴² Megjithatë, KQZ-ja nuk i miratoi gjrobat. Më 15 prill, reklamat u ritransmetuan, pasi u përcaktuan më qartësisht se ishin të paguara nga PS-ja.

Në rastin e dytë, më 23 prill, KQZ-ja nxorri një vendim sipas të cilit urdhëronte transmetuesit të shfaqnin kasetat e përgatitura nga subjektet zgjedhore në rast se stacionet e kishin të pamundur t'i mbulonin me lajme dhe u jepte partive politike kompetenca për të përcaktuar mbulimin me lajme

38 Mbulimi i të gjitha partive, përveç PD-së dhe PS-së në kanalet televizive të monitoruara ishte si më poshtë: *TVSH* (12 përqind), *TV Klan* (7 përqind), *Top Channel* (10 përqind), *News 24* (14 përqind) and *Vizion Plus* (7 përqind).

39 *TV Klan* i kushtoi PD-së 59 përqind të mbulimit me lajme, 27 përqind PS-së dhe 7 përqind qeverisë. *Vizion Plus* i kushtoi PS-së 47 përqind të mbulimit me lajme, 34 përqind PD-së dhe 7 përqind qeverisë.

40 *News 24* i kushtoi 45 përqind të mbulimit me lajme PS-së dhe 33 përqind PD-së dhe 5 përqind qeverisë. *Top Channel* i kushtoi 41 përqind të mbulimit me lajme PS-së, 31 përqind PD-së dhe 12 përqind qeverisë.

41 Vendim i KQZ-së 425, 2011. Neni 84.4 i Kodit Zgjedhor parashikon se vetëm subjektet zgjedhore kanë të drejtën të transmetojnë reklama politike gjatë periudhës zgjedhore.

42 Raporti i BMM-së mbi Monitorimin e Medias drejtuar KQZ-së për periudhën 8–14 prill propozonte që të gjobitej *Top Channel* (3.5 milion lek, d.m.th. 24,831 EUR) dhe *Vizion Plus*, *Ora News* dhe *News 24* (2 milion lek, d.m.th. 14,182 EUR).

të aktiviteteve të partive dhe kandidatëve. Ky vendim shkonte përtej Kodit Zgjedhor dhe binte ndesh me Ligjin mbi Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat.⁴³ Vendimi i KQZ-së u lejonte partive politike të ushtronin ndikim të padrejtë në lirinë editoriale të medias audiovizive. Më 2 maj, vendimi u rrëzua nga Kolegji Zgjedhor.

Më 29 prill, raporti i BMM-së dorëzuar pranë KQZ-së tregonte se PD-ja e kishte kaluar kufirin ligjor prej 90 minutash për reklama fushate në televizion. Megjithatë, KQZ-ja nuk e ndërpreu transmetimin e reklamave të PD-së me argumentimin se kufiri ligjor duhet të zbatohet për reklamën e sponsorizuar nga koalicioni në mbështetje të kandidatëve dhe jo për reklamën e sponsorizuar nga partia. Për pasojë, një javë përpara mbarimit të periudhës së fushatës zgjedhore, KQZ-ja e llogariti edhe një herë kufirin e reklamave me pagesë në TV ku rezultuan 411 minuta për koalicionin e kryesuar nga PD-ja dhe 310 minuta për koalicionin e kryesuar nga SP-ja.

X. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Shqipëria nuk ka ndonjë ligj kuadër të veçantë për pakicat, Kushtetuta garanton të drejta të plota politike, civile dhe shoqërore për pakicat dhe Kodi Zgjedhor garanton të drejtën e të gjithë shtetasve shqiptarë për të votuar dhe për t'u zgjedhur pavarësisht origjinës etnike, racës, fesë ose gjuhës.⁴⁴ Shqipëria është palë në Konventën Kuadër të KE-së për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare⁴⁵ por nuk e ka firmosur Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.

Statusin e pakicës kombëtare e kanë tre grupe: Grek, Maqedonas dhe Malazez.⁴⁶ Komuniteti Rom dhe Vllah/Arumun njihen si pakicë etno-gjuhësore.⁴⁷ Mungojnë të dhënat e sakta mbi pakicat, por besohet se pakica greke përbën grupin më të madh, të ndjekur nga pakica Rome.⁴⁸ Pakicat e tjera përbëhen prej Serbëve, Boshnjakëve, Bullgarëve dhe Egjiptianëve.⁴⁹

Në këto zgjedhje garuan katër parti politike që pretendonin se përfaqësonin pakicat: PBDNJ dhe Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen kandidonin më vete dhe garonin kryesisht për të marrë votat e grekëve etnikë. Aleanca Maqedonase për Integrim Europian i përfshiu kandidatët e saj në Aleancën për Qytetarin, ndërsa Partia e Tolerancës së Re që përfaqësonte interesat e komunitetit rom dhe egjiptian iu bashkua Aleancës për të Ardhmen dhe garoi në 7 NjQV. Përfaqësimi i romëve dhe egjiptianëve mbeti i marxhinalizuar, ndonëse u zgjodhën disa kandidatë romë.

Persona të ndryshëm nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ngritën shqetësimin lidhur me përpjekjet e pretenduara për blerjen e votës në komunitetin rom dhe egjiptian. MVZ-së së OSBE/ODIHR-it iu raportuan raste të presionit të ushtruar prej autoriteteve shtetërore ndaj disa zgjedhësve romë dhe

43 Neni 5 i këtij ligji parashikon se “pavarësia e redaksisë garantohej me ligj”.

44 Një ligj tjetër që lidhet me këtë çështje përfshin Ligjin për Mbrojtjen dhe Diskriminimin 2010.

45 Konventa Kuadër u ratifikua në shtator 1999 dhe hyri në fuqi në fillim të vitit 2000.

46 Shqipëria njih si pakica kombëtare vetëm pakicat me shtetet fqinje (shih ACFC/SR/III(2011)001, ACFC/OP/II(2008)003).

47 Sipas autoriteteve shqiptare, nuk ka asnjë dallim ndërmjet dy kategorive në drejtim të mbrojtjes. Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër është i mendimit se duhet riparë dallimi ndërmjet pakicave “kombëtare” dhe “etno-gjuhësore” (ACFC/OP/II (2008)003).

48 Regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2001 nuk përfshinte pyetje mbi gjuhën, etninë, apo përkatësinë fetare. Llogaritjet e përfaqësuesve grekë dhe Komitetit Shtetëror për Pakicat tregojnë se numri i grekëve është rreth 200 000. OJF-të Rome, Këshilli i Europës dhe autoritetet e llogaritit numrin e romëve nga 90 000 deri në 120 000.

49 Boshnjakët dhe egjiptianët po kërkojnë të njihen përkatësisht si pakica kombëtare dhe etno-gjuhësore.

egjiptianë.⁵⁰ Autoritetet e kanë pranuar mungesën e regjistrimit dhe dokumentave të identifikimit për një pjesë të anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian si një problem që vazhdon prej kohësh çka mund të ketë çuar në humbje të së drejtës së tyre për të votuar. Ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi raste përprjeksh për të influencuar zgjedhësit romë analfabetë.⁵¹

Mbetet i panjohur numri i përfaqësuesve të pakicave kombëtare në administrimin e zgjedhjeve. Një pjesë e përfaqësuesve të grekëve etnikë shprehu nevojën për t'i pasur në gjuhën amtare materialet zgjedhore zyrtare, përfshirë fletët e votimit.⁵² Për këto zgjedhje, KQZ-ja e botoi materialin për informim të zgjedhësve në gjuhën shqipe, greke dhe maqedonase.

XI. PJESËMARRJA E GRAVE

Ligji mbi Barazinë Gjinore në Shoqëri, 2008 parashikon një minimum prej 30 përqind të përfaqësimit të grave në të gjitha institucionet e sektorit publik në nivel qendror dhe vendor. Megjithatë, gratë mbeten pak të përfaqësuara në jetën publike dhe politike, veçanërisht në pozicionet vendimmarrëse.

Kodi Zgjedhor parashikon një kriter gjinor në anëtarësinë e KQZ-së dhe KZAZ-së. Megjithatë, gratë mbeten pak të përfaqësuara në administrimin e zgjedhjeve. Dy nga shtatë anëtarët e KQZ-së janë gra dhe vetëm 3 nga 66 KZAZ-të kryesoheshin prej grave. Gratë përfaqësonin 24 përqind të anëtarëve të KZAZ-së. Në KQV-të e vëzhguara gjatë ditës së zgjedhjeve, vetëm 14 përqind të tyre i kryesonin gratë.

Kodi Zgjedhor parashikon që në zgjedhjet e qeverisjes vendore një në çdo tre emra në listën e kandidatëve duhet t'i përkasë secilës gjini. Partitë që nuk e plotësojnë këtë kriter duhet të paguajnë gjobë, ndonëse lista regjistrohet. Meqë gjoba është e ulët (30 000 lek ose afërsisht 213 EUR), ky kriter shpeshherë nuk u respektua. KQZ-ja me autoritetin si organi për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e këshillit të Tiranës, e gjobiti një parti (PDIU) për mosrespektim të kriterëve gjinore. Ndërsa KQZ-ja e ka autoritetin të vendosë gjoba për shkelje në NjQV të tjera, deri në këtë moment të shkrimit të raportit ajo nuk e ka bërë këtë. KQZ-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se Kodi Zgjedhor nuk parashikon ndonjë afat kohor për të riparë se sa përputhen listat e kandidatëve dorëzuar pranë KZAZ-ve. Mosrespektimi i kriterëve gjinore nuk ndikon te përfitimi i fondeve publike për qëllime fushate për një parti.⁵³ Sipas KQZ-së, rreth 30 përqind e kandidatëve për zgjedhjet e këshillit ishin gra, por kishte vetëm 14 gra ndërmjet 872 kandidatëve për kryetar (1.6 përqind). U zgjodhën gjashtë nga gratë që kandidonin për kryetare.

Pothuajse të gjitha partitë e kontaktuar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it kishin një forum për gratë. Megjithatë, çështjet e barazisë gjinore në përgjithësi nuk trajtoheshin në platformat zgjedhore të partive dhe çështjet që preknin gratë në veçanti nuk pasqyroheshin në fushatën e tyre. Sipas monitorimit të medias në transmetuesit televizivë të monitoruar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it gratë politikane përfitonin mesatarisht 4.4 përqind të mbulimit të përgjithshëm me lajme.

50 MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u njoftua për disa pretendime se zgjedhësit romë dhe egjiptianë i kishin kërcënuar se do t'u ndërprinin asistencën sociale mujore nëse nuk votonin për partinë që drejtonte bashkinë.

51 Përpos kësaj, në një QV zgjedhësve romë analfabetë u ishte mohuar e drejta e votës, ndërsa zgjedhësit analfabetë që nuk ishin romë ishin lejuar të ndihmoheshin dhe të votonin.

52 Ata pretenduan se ka një numër zgjedhësish grekë të vjetër në moshë, sikurse edhe zgjedhës të rinj që kanë lindur jashtë vendit, të cilët nuk e zotërojnë mjaftueshëm gjuhën shqipe.

53 *Udhëzuesi mbi Rregullimin e Partive Politike* i OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, paragrafi 191. Shih gjithashtu pikën 192 ku thuhet, "Eshtë e udhës që shtetet të përcaktojnë në ligj kriteret minimale që duhet të plotësohen përpara marrjes së financimit publike. Kërkesa të tilla mund të përfshijnë... përfaqësimin gjinor të ekuilibruar."

Aftësia e votuesve gra për të ushtruar të drejtën e votës së lirë u influencua nga rastet e shumta e të vazhdueshme të votimit familjar dhe nga persona të tjerë, që u vërejt në 26 përqind të QV-ve të vizituara. Ndërkohë jo të gjitha rastet e vëzhguara ishin domosdoshmërisht raste të burrave që votonin në emër të grave ose që influenconin me zgjedhjen e tyre, vëzhguesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it raportuan se kjo dukej se ishte një tendencë e përgjithshme. Mosparandalimi i votimit familjar dhe votimit nga persona të tjerë, në përputhje me ligjin, bie ndesh me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare në drejtim të fshehtësisë së votës, ushtrimit të lirë të zgjedhjes politike dhe eliminimit të diskriminimit kundër grave në jetën politike.⁵⁴

XII. VËZHguesIT VENDAS

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e procesit zgjedhor nga vëzhgues vendorë dhe përfaqësues të partive politike, koalicioneve dhe nga kandidatë të paraqitur prej grupeve të votuesve, si edhe nga vëzhgues ndërkombëtarë. Me anë të një procesi gjithëpërfshirës, KQZ-ja akreditoi 4 617 vëzhgues vendorë nga 19 OJF të ndryshme, duke i ofruar procesit zgjedhor edhe një element tjetër transparence. Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, shpërndau rreth 170 vëzhgues afatgjatë dhe mbi 900 vëzhgues afatshkurtër. Koalicioni përbëhej prej tre OJF-ve kombëtare: Shoqëria për Kulturë Demokratike, *KRIIK* Albania, dhe Qendra *Kombinat* për Gratë dhe Fëmijët dhe prej 15 OJF-ve rajonale. Grupet e tjera të vëzhguesve vendorë përfshinin Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe Forumin e Vëzhguesve Vendorë që Monitoronin Pjesëmarrjen e Grave në Procesin Zgjedhor.

Partitë mund të emërojnë përfaqësues me përjashtim të rasteve kur bëjnë pjesë në një koalicion. Në raste të tilla, e drejta e emërimit i takon koalicionit. Një numër partish të vogla, të cilat iu bashkuan koalicioneve e kundërshtuan humbjen e së drejtës për të pasur vëzhgues në VNV. Megjithatë, të gjithë kandidatët u lejuan të ishin të pranishëm brenda VNV-ve, duke i lejuar kështu çdo parti të ishte e pranishme.

XIII. ANKESAT DHE APELIMET PËRPARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor u jep të drejtën e depozitimit të një ankese ose apelimi subjekteve zgjedhore, individëve dhe partive politike, të cilave u është refuzuar regjistrimi si subjekte zgjedhore dhe atyre të cilëve u është refuzuar akreditimi si vëzhgues të zgjedhjeve. KQZ-ja shqyrton ankesat mbi zhvillimin e procesit zgjedhor, vendimet e KZAZ-ve dhe mosmarrjen e një vendimi prej KZAZ-ve. Vendimet e KQZ-së dhe mosmarrja e një vendimi mund të apelohe në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit të Tiranës, vendimet e të cilit janë të formës së prerë.

Deri në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja shqyrtoi 57 ankesa kryesisht lidhur me refuzimin e regjistrimit. Argumenti i përsëritur i palëve ankimese ishte se kandidatët nuk kishin mundur të respektonin afatet e regjistrimit, pasi KZAZ-të nuk punonin dhe nuk gjendeshin në zyra, sidomos ditën e fundit të dorëzimit të dokumenteve të kandidimit. Në dy raste të tilla, KQZ-ja zbatoi standarde të ndryshme për partitë parlamentare dhe ato joparlamentare. KQZ-ja i vlerësoi pretendimet si të pavërtetuara dhe nuk pranoi të shqyrtonte çështjen e një partie joparlamentare, por e udhëzoi KZAZ-në që të pranonte dokumentet në rastin tjetër ku ankimesi ishte PS-ja. Në rastin e PS-së, KQZ deklaroi se duhej mbrojtur e drejta e votuesve për të zgjedhur, ndonëse afati ishte shkelur.

54 Shih për shembull paragrafët 5.1, 5.9, 6 dhe 7.4 të Dokumentit të Kopenhagenit OSBE 1990.

Kolegji Zgjedhor përbëhet prej tetë gjykatësve të Gjykatave të Apelit të përzgjedhur me short përpara zgjedhjeve parlamentare.⁵⁵ Ata janë në detyrë deri në zgjedhjet parlamentare të radhës. Për secilën çështje, Kolegji Zgjedhor gjykon në një panel prej pesë nga tetë gjyqtarët, të cilët zgjidhen me short përpara seancës së çështjes.

Gjatë periudhës parazgjedhore, Kolegji Zgjedhor shqyrtoi 33 apeline kundër vendimeve të KQZ-së. Nga këto, 22 apeline u përkisnin regjistrimit të kandidatit ose refuzimit për regjistrim, shumica prej të cilave ishin kundërshtime nga PS-ja dhe PBDNJ-ja lidhur me regjistrimin e kandidatëve të pavarur ose kandidatëve të partive të vogla. Kolegji Zgjedhor rrëzoi tri vendime të KQZ-së: e drejta për t'u regjistruar iu dha dy kandidatëve të pavarur për kryetar dhe një kandidati të Partisë Demokristiane.

PS-ja kundërshtoi tri vendime të KQZ-së me argumentin se KQZ-ja i tejkaloi kompetencat dhe se, në çdo rast, këto vendime përbënin akte normative dhe prandaj duhet të ishin marrë me shumicë të cilësuar prej pesë votash dhe jo me katër vota siç kishte ndodhur në këtë rast. Dy nga vendimet e kundërshtuara të KQZ-së u rrëzuan nga Kolegji Zgjedhor.⁵⁶

Kolegji Zgjedhor i gjykoi shpejt apelimet përpara ditës së zgjedhjeve dhe respektoi të drejtat procedurale të palëve. Megjithatë, nuk ishte e mundur të bëhej një analizë gjithëpërfshirëse e vendimmarrjes së Kolegjit Zgjedhor, pasi ai nuk i shpalli arsyetimet, me përjashtim të gjashtë çështjeve të cilat u shpallën me shumë vonesë.⁵⁷ Neni 158.6 i Kodit Zgjedhor i kërkon Kolegjit Zgjedhor të zbardhë vendimet jo më vonë se tre ditë nga dita e dhënies së tyre. Edhe pse vendimet e Kolegjit Zgjedhor ishin të formës së prerë, arsyetimi i tyre ishte i rëndësishëm, veçanërisht në rastet kur vendimi i KQZ-së kthehej për rishqyrtim.

XIV. VOTIMI DHE NUMËRIMI

A. QENDRAT E VOTIMIT

Ditën e zgjedhjeve MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dhe delegacioni i Kongresit vëzhguan procedurat e hapjes, votimit dhe mbylljes në mbi 1,000 QV në të gjithë vendin. Transparenca e veprimeve gjatë ditës së zgjedhjeve në përgjithësi u vlerësua pozitivisht, por procesi u vlerësua gjithashtu si i ndikuar nga probleme procedurale dhe nga çorganizimi në një numër të konsiderueshëm qendrash votimi. Dita e zgjedhjeve ishte relativisht e qetë krahasuar me periudhën e fushatës, me pak incidente dhune të raportuara. Përfaqësuesit e partive, kryesisht nga dy koalicionet, ishin të pranishëm në 95 përqind të QV-ve të vëzhguara,⁵⁸ ndërsa vëzhguesit vendorë ishin të pranishëm në një të pestën e QV-ve të vizituara. KQZ-ja njoftoi një pjesëmarrje në zgjedhje prej 51 përqind.

55 Sikurse thuhet në seksionin e Kuadrit Ligjor, dy partitë më të mëdha parlamentare kanë të drejtën të heqin njërin prej gjyqtarëve të përzgjedhur me short, në kundërshtim me angazhimet ndaj OSBE-së.

56 Këto tre vendime të KQZ-së kishin të bënin me specifikimet teknike të fletës të votimit, transmetimin e spoteve televizive të përgatitura nga partitë politike për median që ajo t'i përdorte në mbulimin me lajme (shih rubrikën mbi Median), dhe prodhimin e vulave rezervë për fletët e votimit. Dy të parat u rrëzuan nga Kolegji Zgjedhor.

57 Vendimi i parë u botua me një muaj vonesë dhe të tjerë me dy muaj vonesë.

58 Vëzhguesit nga Aleanca për Qytetarin ishin të pranishëm në 90.3 përqind të QV-ve të vëzhguara. Vëzhguesit nga Aleanca për të Ardhmen ishin të pranishëm në 81.6 të QV-ve. Vëzhguesit e PBDNJ-së ishin të pranishëm në 21.2 përqind të QV-ve. Vëzhguesit nga partitë e tjera ishin të pranishëm në 25.7 përqind të QV-ve.

Shumica e QV-ve të vëzhguara u hapën me vonesë (57 nga 75). Disa prej vonesave erdhën si shkak i mungesës së materialeve zgjedhore, përfshirë fletët e votimit, bojën ose kutitë e votimit,⁵⁹ por edhe për shkak të mosmarrëveshjeve të anëtarëve të KQV-ve lidhur me procedurat. Vëzhguesit raportuan probleme procedurale në hapjen e 19 QV-ve dhe persona të paautorizuar brenda 10 QV-ve, shumica aktiviste të partive. Këta faktorë bënë që vëzhguesit ta vlerësonin negativisht hapjen në një numër të madh të QV-ve (21 nga 75). Gabimet në prodhimin ose shpërndarjen e fletëve të votimit rezultuan në moszhvillimin e disa garave zgjedhore dhe votimi u anulua në tetë QV të tjera.⁶⁰

Procesi i votimit u vlerësua si pozitiv prej vëzhguesve në 90 përqind të QV-ve të më shumë se 1,000 QV-ve të vizituara gjatë ditës. Vlerësimi negativ në 10 përqind të tyre ishte kryesisht për shkak të problemeve procedurale, por mbetet gjithsesi një shifër e lartë. Vlerësimi i vëzhguesve varionte nga një qark në tjetrin, me Tiranën të vlerësuar më pozitivisht (94 përqind).⁶¹

Në 16 përqind të QV-ve të vëzhguara nuk u ndoqën gjithmonë procedurat dhe KQV-të dukej se nuk i njihnin procedurat në 12 përqind të rasteve. Kjo ishte veçanërisht e dukshme në procedurat e timbrimit me bojë pasi zgjedhësit nuk kontrolloheshin rregullisht nëse i kishin gishterinjtë të timbruar (20 përqind të vëzhgimit) dhe rastet ku gishtërinjtë e votuesit nuk timbroheshin (7 përqind). Votimi familjar/në grup, që dhunon fshehtësinë e votës, u vërejt në 21 përqind të QV-ve të vizituara. Në shumë QV kishte dyndje (14 përqind) ose rregullim të papërshtatshëm të hapësirës (6 përqind). Mungesa e uniformitetit në ndjekjen e procedurave mund të jetë shkakuar prej emërimit me vonesë të anëtarëve të KQV-ve dhe mungesës së trajnimit të standartizuar. Tensione ose shqetësime u vërejtën brenda 7 përqind të QV-ve të vizituara.

Ndonëse në një shkallë më të vogël se problemet procedurale, u vërejtën gjithashtu një numër parregullish më serioze. Zgjedhësit u frikësuan në 15 raste (në pothuajse 2 përqind të vëzhgimeve) ose u ndikuan në zgjedhjen e tyre në 37 raste (4 përqind). Votimi nga persona të tjerë u vërejt në 5 përqind të QV-ve të vizituara dhe i njëjti person “ndihmonte” votues të ndryshëm në 3 përqind të QV-ve.⁶² Vëzhguesit verifikuan dy raste të mbushjes së kutisë së votimit.

Sikurse u përmend më lart, Kodi Zgjedhor parashikon që qendra votimi të veçanta të ngrihen në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Në zgjedhjet vendore, të burgosurit mund të votojnë vetëm në QV të veçanta nëse e kanë vendbanimin në NjQV-në ku vuajnë dënimin, dhe duhet të ketë minimalisht 15 zgjedhës në çdo QV të veçantë. Për shkak të këtyre kërkesave, vetëm 223 zgjedhës ishin regjistruar në katër QV të veçanta në të gjithë vendin: dy në qarkun e Durrësit dhe nga një në qarkun e Kukësit dhe të Beratit. Kjo do të thotë që shumë të burgosur nuk mundën ta ushtronin të drejtën për të votuar. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, që është nën varësinë e Ministrisë së

59 Kjo u raportua në katër QV në Paskuqan, Rogozhinë dhe Kamëz (qarku Tiranë) dhe në Cërrik (qarku Elbasan).

60 Për shkak të printimit të fletëve të votimit apo të gabimeve në shpërndarje, gara për kryetar bashkie e komune u anulua në komunat Papër dhe Pishaj në qarkun e Elbasanit (KZAZ-të 14 dhe 15), dhe gara për këshillin u anulua në komunën Mollas (KZAZ 31 në Korçë). Zgjedhjet do të përsëriteshin edhe në Shllak (KZAZ 42 në Shkodër), ku nuk u morën të gjitha fletët e votimit për të shtata qendrat e votimit dhe për rrjedhojë komisionerët e PS-së i lanë qendratën e votimit. Komisionerët e PD-së u larguan nga QV-ja nr 2801, Stravaj, (KZAZ 17 në Elbasan). Kolegji Zgjedhor urdhëroi përsëritjen e zgjedhjeve në pesë komuna të tjera, bazuar kryesisht në mospërputhjet ndërmjet numrit të zgjedhësve dhe votave të hedhura (shih rubrikën mbi Ankesat dhe Ankimet Paszgjedhore). Neni 161 i Kodit Zgjedhor parashikon përsëritjen e zgjedhjeve jo më vonë se katër javë nga përfundimi i procesit ankimor.

61 Përqindja e vlerësimit negativ ishte më e lartë në qarkun e Durrësit (15 përqind), Dibër (14 përqind), Fierit (14 përqind), dhe Elbasanit (13 përqind).

62 Neni 108 i Kodit Zgjedhor parashikon që një person mund të ndihmojë vetëm një votues që nuk mund të votojë vetë.

Drejtësisë, lejoi 221 të burgosur të tjerë nga 12 burgje dhe qendra paraburgimi të votonin në QV-të e vendbanimit të tyre të zakonshëm, disa prej të cilëve u shoqëruan prej zyrtarëve të burgjeve. PS-ja aludoi se prania e të burgosurve në disa QV në Tiranë i frikësoi disa zgjedhës.

Ndonëse përpjekjet për t'u dhënë zgjedhësve të drejtën e votimit janë për t'u lavdëruar, transportimi i të burgosurve ditën e zgjedhjeve u krye pa njoftuar paraprakisht KQZ-në, sikurse parashikohet në nenin 4 të Kodit Zgjedhor.⁶³ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk mundi të përcaktonte nëse të gjithë të burgosurit që nuk mundën të votonin në QV të veçanta patën mundësinë të votonin në QV-të e vendbanimit të tyre të zakonshëm.

Vëzhguesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it e vlerësuan procesin e mbylljes si pozitiv në 56 QV nga 72 QV të vëzhguara, ndonëse në 18 QV të vëzhguara procedurat mbyllëse nuk u aplikuan gjithmonë plotësisht, përfshirë mosnumërimin e firmave në Listen Përfundimtare të Zgjedhësve, mosnumërimin e fletëve të papërdorura, mosvendosjen e procesverbalit të mbylljes në kutinë e materialeve dhe mospajisjen e vëzhguesve me kopje të procesverbalit të mbylljes. Në 6 QV pati tension ose trazira gjatë mbylljes dhe mbyllja në disa QV u vonua në mënyrë të panevojshme. Transporti i materialeve në VNV u vlerësua pozitiv për të gjitha QV-të e vëzhguara.

B. VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE

Numërimi i votave në 66 VNV ishte shumë i gjatë. Sipas Kodit Zgjedhor, ai duhet të përfundonte në orën 17:00 të ditës së nesërme të votimit. Ky afat u konsiderua si jo realist nga të gjithë personat e pyetur dhe as edhe një VNV nuk e përfundoi procesin e numërimit deri në atë orë. Numërimi në të gjitha VNV-të jashtë Tiranës përfundoi ditën e premte 13 maj. Numërimi i votave për zgjedhjet e kryetarit të bashkisë së Tiranës në VNV-të e Tiranës përfundoi më 14 maj dhe për zgjedhjet në minibashkitë e Tiranës më 23 maj.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi numërimin e votave në 57 nga 66 VNV-të.⁶⁴ Në shumicën e VNV-ve, numërimi i fletëve të votimit shkoi në mënyrë përgjithësisht transparente, pavarësisht ritmit të ngadaltë. Në mjaft raste, kandidatët për kryetar bashkie a komune që humbën garën, e pranuan humbjen. Megjithatë, procesi i numërimit u shoqërua nga një nivel i lartë i mungesës së besimit mes partive politike, gjë e cila çoi në konflikte, vonesa dhe pengesa në disa VNV. Shpeshherë partitë ndërhyjnë gjatë procesit të numërimit, duke orientuar veprimtarinë e anëtarëve të tyre në komisionet zgjedhore.

Vëzhguesit mund të ishin të pranishëm në VNV-të pa asnjë pengesë. Gjatë numërimit, çdo fletë votimi u filmua dhe u shfaq menjëherë në ekrane për të gjithë vëzhguesit e pranishëm. Megjithatë, fletët e votimit nuk mund të shiheshin gjithmonë për shkak se kaloheshin shumë shpejt. Në përgjithësi, vëzhguesit nuk lejoheshin t'u afroreshin tavolinave të numërimit, kështu që ishte e vështirë të shihej nëse fletët e votimit vendoseshin në stivën e fletëve për kandidatin/partinë korresponduese ose se si plotësoheshin protokollat e rezultateve të QV-ve. Gjithashtu, vëzhguesit nuk mund të shihnin se si anëtarët e grupeve të numërimit dhe të KZAZ-së i vlerësonin fletët e kontestuara.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it e vlerësoi procesin e numërimit të votave në VNV për 1,020 QV të përzgjedhura në mënyrë rastësore. Numërimi u vlerësua negativisht në 14 përqind të vëzhgimeve,

63 Neni 4.3 u kërkon ministrive të informojnë me shkrim KQZ-në lidhur me çdo aktivitet që mund të ndikojë "administrimin ose mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente."

64 MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk e vëzhgoi numërimin në VNV-të e KZAZ-ve 3, 17, 23, 29, 35, 43, 57, 60, 66.

që u përqëndruan në 17 nga 57 VNV-të e vëzhguara.⁶⁵ Problemet procedurale ishin më shumë të lidhura me mosnumërimin e firmave në listat e zgjedhësve (15 përqind të rasteve të vëzhguara), mosverifikimin e vulës së kryetarit të KQV-së mbrapa fletës (9 përqind), dhe mosrakordimit të shifrave në procesverbale. Në 68 përqind të numërimeve të vëzhguara, ku pati fletë votimi të kontestuara, grupet e numërimit nuk i mbajtën shënim arsyet e kontestimit të fletëve të votimit sikurse e kërkon Kodi Zgjedhor, dhe në 36 përqind të këtyre rasteve KZAZ-të nuk i shkruajtën vendimet mbi fletët e kontestuara në librin e protokollit.

Procesi i numërimit u ndikua nga tensione në 25 VNV dhe nga prania e personave të paautorizuar në 30 VNV, ndonëse ata në përgjithësi nuk ndërhyjnë në procesin e numërimit. Njohja në tërësi e procedurave të numërimit u vlerësua si e dobët në 10 VNV.

U shënuan disa raste të pakta parregullish serioze në disa VNV. Disa anëtarë të një KZAZ-je, si nga shumica ashtu edhe nga opozita, informuan vëzhguesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se ishin kërcënuar direkt dhe për pasojë kishin shpallur të pavlefshme disa fletë votimi në garën për kryetar të një NjQV-je me qëllim që të ndryshonin rezultatin. Disa parti të vogla pretenduan se anëtarët e grupit të numërimit në një numër VNV-sh, në mënyrë të paligjshme, kishin shpërndarë votat për këto parti në favor të PD-së dhe PS-së në disa gara për këshillat. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it e vëzhgoi drejtpërdrejt këtë falsifikim gjatë numërimit për garën për këshill të një NjQV-je.

Fillimi i procesit të numërimit nisi me vonesë në shumë VNV, pjesërisht për shkak të faktit se disa anëtarë të grupeve të numërimit në disa VNV nuk ishin emëruar apo trajnuar ende deri në momentin që filloi numërimi. Për më tepër, procesi i numërimit ndonjëherë ndërpritej për shkak të debateve mes anëtarëve të KZAZ-së, anëtarëve të grupit të numërimit dhe/ose përfaqësuesve të partive.⁶⁶ Një tjetër arsye vonese ishte lodhja e anëtarëve të KZAZ-së, pasi nuk ka asnjë rregullore për orarin e punës të VNV-ve.⁶⁷ Në disa raste specifike që u sollën në vëmendje të KQZ-së, ajo i trajtoi këto vonesa duke urdhëruar vazhdimin e procesit.

Gjatë procesit të numërimit, KQZ-ja vazhdoi të zëvendësonte anëtarët e KZAZ-së dhe të grupeve të numërimit me kërkesë të partive politike. Kjo u vërejt sidomos në Tiranë, ku KQZ-ja i zëvendësoi të gjithë anëtarët e KZAZ-së 54 dhe disa anëtarë të KZAZ-së 49 në datë 12 maj, dhe kryetarin e KZAZ-së 48 dhe një anëtar të KZAZ-së 47 në datë 13 maj, gjë që shkaktoi edhe më shumë vonesa.

Kopje të tabelave të rezultateve të QV-ve dhe të tabelave përmbledhëse të rezultateve për NjQV-të iu vunë në dispozicion përfaqësuesve të partive, gjë që rriti transparencën.

C. NUMËRIMI DHE VLERËSIMI I VOTAVE NË TIRANË

Qyteti i Tiranës është i ndarë në 11 minibashki, ku secila ka KZAZ-në dhe VNV-në e vet. Përveç zgjedhjeve të Kryetarit dhe Këshillit Bashkiak të Tiranës, çdo minibashki zhvillon zgjedhje për kryetarin dhe këshillin e vet. Pra, çdo QV në Tiranë kishte katër kuti votimi. Në bazë të një vendimi të KQZ-së para ditës së zgjedhjeve, VNV-të në Tiranë hapën në fillim kutitë për Kryetar dhe Këshill Bashkiak të Tiranës dhe numëruan fletët e votimit dhe, pas tyre, hapën kutitë dhe numëruan fletët e votimit për kryetar dhe këshill të minibashkisë. Numërimi në këto VNV

65 Këto ishin VNV në KZAZ-të 1, 5, 14, 16, 18, 25, 26, 33, 34, 39, 41, 42, 47, 51, 52, 58 dhe 65.

66 KZAZ-ja 31 në Ersekë, 32 në Pogradec, 34 në Kukës, 44 në Kopik, 41 në Shkodër, 42 në Kukës, 62 dhe 63 në Vlorë dhe 65 në Ksamil.

67 Kodi Zgjedhor nuk parashikon pushime gjatë procesit të numërimit, pasi numërimi duhet të ketë përfunduar deri në orën 17.00 të ditës së nesërme të votimit. Udhëzimet e KQZ-së mbi numërimin nuk e trajtonin këtë çështje.

shpeshherë u vonua prej pushimeve të paplanifikuara, mungesës së anëtarëve të grupit të numërimit dhe pengesave që ndonjëherë dukeshin të motivuara politikisht. Numërimi në VNV për Kryetar dhe Këshill Bashkiak të Tiranës përfundoi më 14 maj, pothuajse një javë pas ditës së zgjedhjeve.

Në përfundim të numërimit në VNV për kryetar bashkie të Tiranës, rezultatet paraprahe që KQZ-ja i dha MVZ-së së OSBE/ODIHR-it e nxirrnin Z. Rama (PS) me 10 vota më shumë se Z. Basha (PD) (124,623 dhe 124,613 vota secili).⁶⁸ Z. Rama deklaroi menjëherë fitoren, ndërsa Z. Basha u shpreh se do të priste për rezultatin zyrtar nga KQZ-ja.

Ndërsa vazhdonte numërimi i kutive të votimit për minibashkitë e Tiranës, zyrtarë të PD-së kërkuan që votat për garën për kryetar bashkie të Tiranës të hedhura në kutitë e gabura të numëroheshin si të vlefshme, me argumentimin se vullneti i votuesve ishte i qartë dhe se neni 117.3 i Kodit Zgjedhor, që rendit arsytet e shpalljes së pavlefshme të votave, nuk shprehet se fletët e votimit të hedhura në kutitë e gabuara duhet të konsiderohen si të pavlefshme. PS-ja kundërshtoi fuqishëm, duke u shprehur se fletët e gjetura në kutitë e gabuara ishin konsideruar gjithmonë të pavlefshme deri në atë moment, si në zgjedhjet vendore 2011 ashtu edhe në zgjedhjet e mëparshme. PS-ja i kërkoi KQZ-së që të nxirrte tabelat e rezultateve për garën për kryetar bashkie siç i kishin përcaktuar 11 VNV-të në tabelat e tyre përmbledhëse të rezultateve, në përputhje me nenin 122 dhe 123 të Kodit Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor nuk e rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë vlefshmërinë e fletëve të gjetura në një kuti votimi të ndryshme nga ajo që i korrespondon llojit të zgjedhjeve për atë fletë votimi. Ai as nuk parashikon ndonjë procedurë për trajtimin e fletëve të gjetura në kutitë e tjera. Përpara ditës së zgjedhjeve nuk pati asnjë vendim apo udhëzim të KQZ-së lidhur me këtë çështje, ndonëse fletët e hedhura gabim kanë qenë problem edhe në zgjedhjet vendore të mëparshme, ashtu si edhe asnjë përfaqësues i ndonjë partie politike nuk e ngriti këtë çështje në seancat e KQZ-së. Manuali i numërimit i miratuar nga KQZ-ja nuk e trajtonte çështjen e fletëve të hedhura gabim. Anëtarët e grupeve të numërimit duket se ishin trajnuar që t'i konsideronin fletët të tilla si të pavlefshme, dhe mesa duket, në të gjithë vendin, grupet e numërimit i kishin konsideruar të pavlefshme votat e hedhura gabim, përfshirë edhe në Tiranë deri në përfundim të numërimit për garën për kryetar bashkie më 14 maj.

Deri më 16 maj, KQZ-ja i mori të 11 tabelat përmbledhëse të rezultateve, ndonëse rezultati për KZAZ-në 49 nuk ishte miratuar prej shumicës së anëtarëve (në këtë rast, shumicën e përbënin partitë në qeveri).⁶⁹ Më 17 maj, Kryetari i KQZ-së propozoi një projektvendim, sipas të cilit fletët e hedhura në kutitë e gabuara në Tiranë do të konsideroheshin të vlefshme dhe do të numëroheshin prej vetë KQZ-së.⁷⁰ Ky numërim do të bëhej vetëm për fletët e gjetura në kutitë e gabuara, që ishin kontestuar në nivel VNV-je. Sipas Kryetarit të KQZ-së, projektvendimi u propozua për shkak të kërkesave identike të bëra prej anëtarëve të PD-së dhe LSI-së në 7 KZAZ të Tiranës në lidhje me 60 kuti votimi. Kryetari i KQZ-së u shpreh se KQZ-ja e kishte të drejtën të numëronte votat e kontestuara për Tiranën, sepse KQZ-ja funksionon si KZAZ në zgjedhjet për Kryetar dhe Këshill Bashkiak të Tiranës. Anëtarët e opozitës e kundërshtuan propozimin, duke u shprehur se KQZ-ja nuk kishte asnjë të drejtë të numëronte votat dhe mund të hapte kutitë vetëm pas një ankimi të vendimit mbi rezultatet zyrtare. Ata propozuan që KQZ-ja të nxirrte tabelën e rezultateve nga

68 Këto rezultate paraprahe, KQZ-ja i paraqiti në faqen e saj elektronike pas një jave.

69 Kjo ishte KZAZ-ja në minibashkinë nr. 5, VNV-ja e fundit që mbaroi numërimin për zgjedhjet për Kryetar dhe Këshill Bashkiak në Tiranë. Kryetari i KZAZ-së 49 pretendoi se kishte pasaktësi në tabelën përmbledhëse të rezultateve. Këto nuk iu specifikuan MVZ-së së OSBE/ODIHR-it.

70 Projektvendimi "Mbi Vlerësimin e Fletëve të Votimit për Kryetar dhe Këshill Bashkiak në Tiranë të Gjetura në Kutinë e Gabuar."

tabelat përbledhëse të rezultateve që kishte marrë prej VNV-ve.

Më 18 Maj, KQZ filloi hapjen e kutive të votimit të identifikuar në kërkesat e KZAZ-ve dhe të numëronin votat e gjetura për Kryetar dhe Këshill Bashkiak të Tiranës. Hapja e kutive të Votimit u mbështet në një projektvendim të votuar “në parim” (me një votim 4-3). Meqë ky vendim i KQZ-së nuk ishte një vendim i shkruar, i formës së prerë, nuk kishte asnjë dokument të disponueshëm publik ku të shprehej baza ligjore për veprimet e KQZ-së. Kështu që asnjë subjekt zgjedhor nuk kishte mundësi të kundërshtonte veprimet e KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor deri në përfundim të këtyre veprimeve. Projektvendimi jozyrtar i propozuar prej Kryetarit nuk ofronte një bazë të qartë ligjore për veprimet e KQZ-së, por rendiste një sërë nenesh që nuk dukej të kishin lidhje të drejtpërdrejta me veprimet e KQZ-së. KQZ-ja filloi hapjen e kutive të votimit menjëherë pas votimit të vendimit “në parim”, çka tregon se kutitë e votimit ishin sjellë që më parë në ambientet e KQZ-së.

Gjatë procesit të vlerësimit të votave të hedhura gabim, KQZ-ja e shtriu numërimin në 117 kuti votimi në 9 nga 11 KZAZ-të e Tiranës. KQZ-ja nuk vlerësoi vetëm fletët e hedhura gabim që ishin kontestuar nga grupet e numërimit, por edhe fletët që ishin vlerësuar të pavlefshme nga grupet e numërimit dhe KZAZ-të gjatë numërimit. Më 23 maj, me përfundimin e procesit, KQZ-ja miratoi me një votim 4-3 Vendimin 709, që rregullonte *a posteriori* veprimet që kishte ndërmarrë KQZ-ja gjatë procesit të vlerësimit.⁷¹ Në vendim përdorej një bazë ligjore e ndryshme nga ajo e cituar në projektvendimin e 18 majit. PS-ja e apeloj vendimin në Kolegjin Zgjedhor.

Po atë ditë, KQZ-ja shpalli rezultatet zyrtare të garës për kryetar bashkie të Tiranës, me një avantazh prej 81 votash për Z. Basha (124,786 vota), kundrejt Z. Rama (124,705 vota). Rezultatet e shpallura nga KQZ-ja për garën për kryetar bashkie të Tiranës përmbanin 870 vota më shumë se firma në LPZ. KQZ-ja nuk i miratoi kërkesat e PS-së dhe anëtarëve të KQZ të propozuar nga pakica për ta hetuar këtë çështje.⁷² Kodi Zgjedhor nuk parashikon çfarë veprimesh duhen ndërmarrë kur ka mospërputhje ndërmjet numrit të fletëve të hedhura dhe numrit të votuesve që kanë votuar sipas numrit të firmave në LPZ.⁷³ PS-ja e apeloj vendimin e KQZ-së për rezultatet në zgjedhjet për kryetar bashkie të Tiranës më 26 maj.

Përsa i përket zgjedhjeve për kryetar të bashkisë së Tiranës, KQZ u përball me një situatë ligjore të paqartë në një mjedis tejet të ngarkuar politik. KQZ-ja mund të kishte zgjedhur të mblidhte rezultatet e paraqitura nga KZAZ-të e Tiranës, dhe, më pas, të merrte parasysh ankimime të mundshme në lidhje me fletët e hedhura gabim. Fakti që anëtarët e KQZ-së të propozuar nga shumica zgjodhën që të numëronin direkt disa (dhe jo të gjitha) fletë të hedhura gabim, në mënyrë jokonsensuale, pas njohjes së rezultateve paraprake dhe pa marrë një vendim që mund të ishte ankimuar në Kolegjin Zgjedhor, krijoi perceptimin se ata po vepronin në favor të shumicës qeverisëse. Ndonëse vendimet e saj u lanë pjesërisht në fuqi nga Kolegji Zgjedhor (shih më poshtë), veprimet e KQZ-së lëkundën besimin në aftësinë e saj për të funksionuar në mënyrë të paanshme dhe të pavarur.

71 Vendimi 709 mbi “Vlerësimin e fletëve të pavlerësuar dhe të panumëruara për kryetar bashkie, këshill bashkiak, kryetarë të njësisë bashkiake dhe këshillave të njësisë bashkiake, të cilat gabimisht nuk ishin hedhur në kutinë përkatëse të votimit në të njëjtën qendër votimi gjatë zgjedhjeve vendore në bashkinë e Tiranës më 8 maj 2011”.

72 Për shembull, tabela përbledhëse e rezultateve për garën për kryetar bashkie të Tiranës në minibashkinë nr. 5, tregoi se pati mospërputhje në 28 nga 65 qendrat e votimit në minibashki, ku u rezultuan 32 më shumë vota sesa firma.

73 Përveç regjistrimit të faktit në Procesverbalin e Konstatimeve të KZAZ-së (neni 116.5 dhe 6 i Kodit Zgjedhor).

XV. MBLEDHJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE NGA KQZ-JA

Kodi Zgjedhor nuk e parashikon nxjerrjen e rezultateve paraprake. Megjithëse rezultatet paraprake për bashkitë dhe komunat për çdo garë u vunë në dispozicion, shpallja publike e rezultateve paraprake nga KQZ-ja fillimisht nuk u realizua në nivel QV-je, në ndryshim nga praktika e ndjekur në zgjedhjet e mëparshme. Megjithatë, me anë të një kërkesë, partitë politike ashtu si edhe MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mundën ta merrnin këtë informacion nga KQZ-ja. Më vonë, në faqen elektronike të KQZ-së u shfaq nënndarja e paplotë e rezultateve sipas QV-ve. Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, rezultatet ende nuk ishin plotësisht të disponueshme në faqen elektronike të KQZ-së.

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve të KQZ të propozuar nga shumica dhe pakica u shtuan gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë së Tiranës, kur shumica e vendimeve të KQZ-së u miratuan me votat e katër anëtarëve të shumicës kundër votave të anëtarëve të pakicës, në veçanti vendimet lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e votave të gjetura në kutinë e gabuar dhe miratimin e rezultateve të zgjedhjes së kryetarit të bashkisë së Tiranës. Diskutimet ndërmjet anëtarëve të KQZ-së dhe përfaqësuesve të partive politike ndonjëherë u bënë armiqësore dhe të nxehta, duke pasqyruar dhe nxitur tensionin e periudhës paszgjedhore.

Më 26 maj, pas miratimit të tabelave të rezultateve për këshillat vendorë nga KZAZ-të, KQZ-ja filloi të miratonte ndarjen e mandateve në ato NjQV, rezultatet e të cilave nuk ishin ankimuar. Njëzëri, anëtarët e KQZ-së i miratuan të gjitha vendimet për ndarjen e mandateve, me përjashtim të Tiranës. Këtu, ndarja e mandateve për këshillin bashkiak të Tiranës dhe për 10 nga 11 minibashkitë u kundërshtua nga anëtarët e KQZ-së të propozuar nga pakica. Meqë ndarja e mandateve për zgjedhjet e këshillit kërkon shumicë të cilësuar, KQZ-ja nuk arriti të merrte një vendim në këto raste. PD-ja apeloi në Kolegjin Zgjedhor, i cili miratoi ndarjen e mandateve për bashkinë e Tiranës (28 për koalicionin e kryesuar nga PD-ja dhe 27 për koalicionin e kryesuar nga PS-ja) dhe për 10 minibashkitë e tjera. Formula e përdorur për ndarjen e mandateve përfshinte pragjet e cituar në nenin 162 të Kodit Zgjedhor për zgjedhjet parlamentare. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk ka dijeni për ndonjë apelim depozituar prej partive apo kandidatëve kundër përdorimit të pragut në ndarjen e mandateve për këshillin vendor.

XVI. ANKESAT DHE APELIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

A. GJYKIMI I ANKESAVE PASZGJEDHORE NGA KQZ-JA

Subjektet zgjedhore mund të ankimojnë në KQZ tabelën e rezultateve të miratuar nga KZAZ-të brenda tre ditësh. Tabela përmbledhëse e rezultateve për Kryetarin dhe Këshillin Bashkiak të Tiranës e nxjerrë nga KQZ-ja mund të ankimohet në vetë KQZ-në brenda të njëjtit afat kohor. Subjektet zgjedhore mund të kërkojnë shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në QV të caktuara jo më vonë se tre ditë nga nxjerrja e tabelave të rezultateve. Brenda 10 ditësh, KQZ-ja duhet të marrë një vendim me shumicë të cilësuar lidhur me ankesat. Vendimet e KQZ-së mund të apelojnë në Kolegjin Zgjedhor brenda pesë ditëve.

Në periudhën paszgjedhore u depozituan 108 ankesa në KQZ-së ku kundërshtoheshin rezultatet në komuna dhe bashki në të gjithë vendin, përfshirë pesë ankesa ku kundërshtoheshin rezultatet e garës për kryetar bashkie të Tiranës. Këto ankesa përfshinin 40 kërkesa për shpalljen e pavlefshme të rezultateve, ndërsa në të tjerat kërkoheshin ndryshime të tabelës së rezultateve dhe rinumërim. Përafërsisht gjysma ishin depozituar nga PD-ja dhe PS-ja. Ankesat paraqisnin parregullsitë gjatë

procedurës së votimit, si për shembull votimi nga një person tjetër në emër të dikujt, si edhe gjatë procesit të numërimit kryesisht lidhur me vlefshmërinë e fletëve të votimit dhe shpërndarjen sipas partive. KQZ-ja shqyrtoi 86 ankesa në themel, ndërsa pjesa tjetër u rrëzua për shkaqe procedurale ose u tërhoq prej ankimesve.

KQZ-ja fillimisht i shqyrtoi ankesat me hollësi, duke shqyrtuar provat dhe duke thirrur anëtarët e KZAZ-së për të dhënë shpjegime. Pas datës 14 maj, një kohë e konsiderueshme iu kushtua diskutimeve të zgjatura lidhur me procesin e hartimit të tabelat të rezultateve për garën për kryetar bashkie të Tiranës. Që nga 17 maji, shqyrtimi i ankesave filloi të shtyhej pambarimisht dhe përfundoi vetëm pas disa javësh, pasi KQZ-ja kishte shpallur rezultatet për kryetar bashkie të Tiranës. Për rrjedhojë, KQZ-ja nuk e respektoi afatin prej 10 ditësh për marrjen e një vendimi në 42 raste ankesash.

Në një numër të madh rastesh, pretendimet e ankimesve nuk mbështeteshin në prova të forta. Edhe në rastet kur ankimesit mund t'i vërtetonin parregullsitë e mëdha, në shumicën e rasteve anëtarët e KQZ-së votuan në linja partiake. Provat u shqyrtuan kryesisht kur ankimesi i përkiste koalicionit të kryesuar nga PD-ja. KQZ kundërshtoi të shqyrtonte regjistrimet filmike nga VNV-të. Mungesa e kolegjalitetit e bëri pothuajse të pamundur pranimin e ankesave pasi ligji kërkon një shumicë të cilësuar votash të pesë anëtarëve. Pamundësia për të arritur shumicën e kërkuar përbënte arsyen e vazhdueshme për rrëzimin e shumicës së ankesave; vetëm tre ankesa u pranuan.

Në përgjithësi, KQZ-ja nuk arriti t'u ofronte ankimesve zgjidhje të efektshme të çështjeve. Shumicës së vendimeve të KQZ-së, në kundërshtim me dispozitat përkatëse, iu mungonte arsyetimi i plotë dhe disa prej tyre nuk përmbanin madje as faktet dhe rrethanat e plota të çështjes në shqyrtim. KQZ-ja nuk e respektoi afatin 24-orësh për zbardhjen dhe botimin e vendimeve. Ky fakt i detyroi subjektet zgjedhore që t'i ankimonin çështjet në Kolegjin Zgjedhor pa vendimet zyrtare të KQZ-së dhe t'i mbështesnin apelimet e tyre në projektvendime pa numra por vetëm me firmën e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së.

B. GJYKIMI I APELIMEVE PASZGJEDHORE NGA KOLEGJI ZGJEDHOR

Në Kolegjin Zgjedhor u depozituan rreth 56 apeleme pas ditës së zgjedhjeve. Shumica e tyre ishin kërkesa për shpalljen e pavlefshme të rezultateve në QV dhe kërkesa për rinumërim, ndërsa pjesa tjetër përbëhej prej ankimesh të vendimeve të KQZ-së lidhur me ndarjen e mandateve. Kolegji Zgjedhor pranoi pesë kërkesa për shpalljen e pavlefshme të rezultateve të QV-së dhe për përsëritjen e zgjedhjeve në NjQV-të në Armen, Kolsh, Finiq, Shalë dhe Qendër, mbështetur kryesisht në mospërputhjen ndërmjet numrit të votuesve dhe votave të hedhura. Ai urdhëroi gjithashtu KQZ-në të kryente rinumërim të votave në disa QV në NjQV-të në Maqellarë Karbunarë, Zharrëz dhe Shushicë.

Tetë prej apelimeve i përkisnin rezultateve të garës për kryetar bashkie të Tiranës, gjashtë të depozituara prej PS-së dhe dy prej Partisë Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë (PBPPSH).⁷⁴ Apeli i parë u depozitua më 23 maj dhe i kërkonte Kolegjit të detyronte KQZ-në të nxirrte tabelën e rezultateve për KZAZ-në 49 dhe për bashkinë e Tiranës në bazë të tabelave të dorëzuara nga grupet e numërimit dhe KZAZ-të përkatëse. Apeli u rrëzua.

⁷⁴ PBBSH e tërhoqi njëri nga kërkesëpadi, ndërsa tjera u rrëzua nga Kolegji.

Më pas, PS-ja dorëzoi një apelim kundër projektvendimit të KQZ-së të 18 maj, por apelimi u tërhoq kur Kolegji refuzoi gjykimin e përbashkët me një apelim të dytë të PS-së.⁷⁵ Në këtë të fundit, PS-ja kërkonte shfuqizimin e vendimit 709 të KQZ-së me pretendimin se ai përbënte “akt normativ” dhe si i tillë duhej miratuar me shumicë të cilësuar. PS-ja pretendonte gjithashtu se ky vendim ishte i paligjshëm, sepse KQZ-ja i kishte tejkalluar kompetencat e saj duke vlerësuar, me anë të një procedure të paparashikuar në ligj, fletë votimi që ishin vlerësuar më parë nga KZAZ-të. PS-ja më tej pretendoi se ky vendim ishte arbitrar dhe se ai, në të vërtetë, ndryshonte rregullat e zgjedhjeve për të ndryshuar rezultatin, duke shpërfillur praktikën e mëparshme lidhur me vlefshmërinë e fletëve të hedhura gabim.

Kolegji Zgjedhor (vendimi 49) e rrëzoi këtë apelim dhe la në fuqi vendimin 709 të KQZ-së. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor përmbante kontradikta dhe boshllëqe në arsyetim: për shembull, Kolegji përcaktoi se vendimi 709 i KQZ-së nuk përbënte akt normativ, pavarësisht se pranoi që ai rregullonte një situatë të re. Gjithashtu në vendimin e Kolegjit Zgjedhor pranohej se KQZ-ja kishte vepruar si KZAZ, pa sqaruar bazën ligjore.

Më pas PS-ja depozitoi një tjetër apelim ku kërkonte shfuqizimin e vendimit 710 të KQZ-së (mbi tabelën përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-së 49) dhe vendimit 711 (mbi tabelën përmbledhëse të rezultateve dhe shpalljen e rezultatit për kryetarin e bashkisë së Tiranës) që ishin përgatitur në bazë të vendimit 709.⁷⁶ Argumentet e palës ankimese ndryshonin shumë pak nga ato në seancën e mëparshme, kurse PD-ja pretendoi se objekti i kërkesëpadisë ishte gjykuar tashmë. Për të parën herë, PS-ja u shpreh se kishte mospërputhje ndërmjet numrit të votuesve dhe fletëve të votimit në një numër qendrash votimi të disa KZAZ-ve në Tiranë.

Më 13 qershor, Kolegji Zgjedhor vendosi që t’i pranonte pjesërisht apelimet dhe të shfuqizonte vendimet 710 dhe 711 si dhe urdhëroi KQZ-në të hapte më shumë kuti votimi dhe të rinumëronte e rivlerësonte votat e hedhura gabim. Me një gjuhë të paqartë dhe të dykuptimtë, vendimi e shtriu hetimin edhe tek fletët e hedhura gabim që ishin gjykuar të pavlefshme nga KZAZ-të. Vendimi ua atribuonte mospërputhjet faktit që hetimi që kishte ndërmarrë KQZ-ja për votat e hedhura gabim kishte qenë i pjesshëm dhe përfundonte se duhej bërë një vlerësim i plotë i të gjitha votave të hedhura gabim për ta rregulluar këtë mospërputhje. Duke urdhëruar një hetim që nuk e kishte kërkuar asnjëra prej palëve në këtë çështje, duket se Kolegji Zgjedhor i tejkalloi kompetencat e tij.⁷⁷ Mospërputhja e këtij vendimi me vendimin 49 të Kolegjit Zgjedhor u shpreh në mendimin e pakicës të dy prej pesë gjyqtarëve.

Më 18 qershor, KQZ-ja filloi hapjen e 1,793 kutive të votimit të cilat ende nuk i kishte hapur, dhe vlerësimin e votave të hedhura gabim. Ky veprim u krye në mjediset e KQZ-së në tetë tavolina numërimi, ku për çdo tavolinë kishte dy numërues nga personeli i KQZ-së dhe nga një vëzhgues të PD-së dhe PS-së. Seancat u zhvilluan në një atmosferë të tensionuar dhe të ashpër që çoi në përjashtimin e vëzhguesve të partive nga Kryetari i KQZ. PS-ja kundërshtoi hapjen e disa kutive me argumentin se kishte mospërputhje ndërmjet numrit të serisë së vulave dhe numrave të serisë të regjistruara në procesverbale dhe me argumentin se kutitë ishin dëmtuar, ndoshta gjatë transportit. Duke thënë se integriteti i këtyre kutive nuk ishte i garantuar, përfaqësuesit e PS-së dhe anëtarët e KQZ të emëruar nga pakica kërkuan hetim të plotë. Këto kërkesa u refuzuan nga Kryetari i KQZ-së me argumentin se KQZ vetëm po zbatonte një vendim gjykate. Vlerësimi i vlefshmërisë së

⁷⁵ Kolegji Zgjedhor refuzoi gjykimin për arsye procedurale, meqë nuk kishin përfunduar veprimet paraprake të nenit 154 të Kodit Zgjedhor për kërkesëpadinë e dytë.

⁷⁶ Kërkesëpadia kundërshtonte vendimin 827 të KQZ-së që rrëzonte ankesat që lidheshin me të.

⁷⁷ Neni 6 i Kodit të Procedurave Civile parashikon që gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen duhet të shprehë mendimin lidhur me gjithçka që i është paraqitur përpara kësaj mosmarrëveshjeje dhe vetëm për çfarë është paraqitur.

votave u realizua në bazë të respektimit të vullnetit të zgjedhësit dhe shpeshherë, në kundërshtim me dispozitat e nenit 117.3 të Kodit Zgjedhor që përcakton pavlefshmërinë e votave. Më 25 qershor, KQZ-ja e shpalli Z. Basha fitues të garës për kryetar bashkie të Tiranës, me një diferencë tashmë prej 93 votash. Tabela përmbledhëse e rezultateve vazhonte të tregonte një mospërputhje prej 870 fletë votimi më shumë se votues.

PS i kundërshtoi këto rezultate në një ankesë drejtuar KQZ-së, me anë të së cilës ajo kundërshtonte mënyrën se si KQZ-ja i kishte hapur kutitë dhe kishte vlerësuar fletët e votimit dhe kërkonte shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në 284 QV. KQZ-ja nuk e shqyrtoi ankesën në themel, por e rrëzoi mbi baza procedurale. Konkretisht, KQZ-ja vendosi që i mungonte kompetenca për të shqyrtuar veprimet e veta, meqë po zbatonte një vendim të Kolegjit Zgjedhor. Lidhur me kërkesën për pavlefshmëri, KQZ-ja vendosi që kishte kaluar afati. Më pas, PS-ja depozitoi një apelim në Kolegjin Zgjedhor për pavlefshmëri të 284 QV-ve. Pak ditë më vonë, ajo depozitoi edhe një tjetër apelim ku i kërkonte Kolegjit që ta detyronte KQZ-në të shqyrtonte ankesën e tyre në themel. PS vendosi ta tërhiqte kërkesën për pavlefshmëri pasi PD-ja kërkoi gjykim të përbashkët të të dyja çështjeve.

Kolegji Zgjedhor e la në fuqi vendimin e KQZ-së për të mos e shqyrtuar ankesën në themel. Ai vendosi se afati prej tri ditësh, brenda të cilit një subjekt zgjedhor mund të kërkonte pavlefshmëri, filloi kur KQZ-ja shpalli rezultatin më 23 maj me vendimin 711. Megjithatë, ky vendim ishte në kundërshtim me vendimin e mëparshëm të Kolegjit Zgjedhor për shfuqizimin e vendimit 711 të KQZ-së.

Në përgjithësi, gjykimi i apeliave në Kolegjin Zgjedhor gjatë periudhës pas zgjedhore paraqiti një tablo të ndryshueshme. Kolegji rrëzoi vendime problematike të KQZ-së dhe urdhëroi shpalljen e pavlefshmërisë dhe rinumërimin në ato NjQV ku autenticiteti i rezultateve vihej me të drejtë në dyshim. Vendimmarrja e Kolegjit për çështjet e lidhura me garën e Tiranës u karakterizua nga kundërshti dhe paqëndrueshmëri. Kolegji Zgjedhor nuk i shfrytëzoi të 10 ditët që parashikon Kodi Zgjedhor për të marrë vendimet. Me përjashtim të dy rasteve, Kolegji Zgjedhor e shpalli vendimin në të njejtën ditë, duke vënë në pikëpyetje kujdesin me të cilin ishte vlerësuar një sasi e madhe provash.

XVII. REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme jepen për t'u pasur parasysh nga autoritetet, partitë politike, administruesit e zgjedhjeve dhe shoqëria civile e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të mëtejshme të përpjekjeve të tyre për të zhvilluar zgjedhje në përputhje të plotë me angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Shumica e rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar 2009 të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it si dhe në Opinionin Ligjor të Përbashkët të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias 2009, gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në zgjedhjet për qeverisjen vendore 2011. Rekomandimet e mëposhtme plotësojnë rekomandimet e mëparshme dhe duhen marrë parasysh dhe trajtuar bashkë me to.⁷⁸ OSBE/ODIHR-i është i gatshëm të ndihmojë Republikën e Shqipërisë për të përmirësuar më tej procesin zgjedhor.

⁷⁸ Rekomandimet e mëposhtme nga Raporti Përfundimtar 2009 i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në zgjedhjet për qeverisjen vendore 2011: 1, 3, 6, 7, 8, 9, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 22, 23, 24, 25, dhe 28.

A. REKOMANDIME PRIORITARE

1. Rekomandimi i parë nga Raporti Përfundimtar i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it mbi zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 duhet konsideruar si prioritet i menjëhershëm: Partitë politike duhet të tregojnë vullnet politik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike që u korrespondon privilegjeve të mëdha që gëzojnë sipas ligjit në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve. Ato duhet të përmbushin detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme në interesin e përgjithshëm të Shqipërisë. Kjo vlen edhe për punën e komisionerëve zgjedhorë dhe nëpunësve të zgjedhur e të emëruar të të gjitha niveleve, të cilët nuk duhet t'i mbështesin veprimet dhe vendimet e tyre në lidhje me zgjedhjet mbi çështje apo bindje politike.
2. Reforma zgjedhore duhet të zhvillohet kohë përpara zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Në diskutimin e reformës zgjedhore duhet të përfshihen jo vetëm partitë politike, por edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, autoritetet përkatëse shtetërore dhe grupet e vëzhguesve vendorë.
3. Formula për përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të rishqyrtohet me qëllim për të rritur besimin në pavarësinë e tij dhe zbatimin e paanshëm të Kodit Zgjedhor nga ana e tij.
4. Partitë politike duhet të jenë të detyruara të respektojnë afatet në procesin zgjedhor, veçanërisht lidhur me emërimin dhe trajnimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore. Kodi Zgjedhor duhet të saktësojë masat që duhen zbatuar kur nuk respektohen këto afate.
5. Afatet ligjore për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet vendore duhet të sinkronizohen me afate praktike si për shembull afati për printimin e fletëve të votimit dhe afatet për ankimim. Kjo vlen veçanërisht në zgjedhjet vendore, meqenëse numri dhe lloji i fletëve të votimit që printohen është shumë më i madh se në zgjedhjet parlamentare.
6. Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar për të trajtuar çështjen e vlefshmërisë së fletëve të hedhura në kutinë e gabuar, procedurat për përfshirjen e këtyre fletëve në tabelën e rezultateve dhe procedurat që duhen ndjekur në raste mospërputhjes kur numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti e kalon numrin e firmave në listën e zgjedhësve. Gjithashtu Kodi Zgjedhor mund të përmirësohet nga një rishikim i përkufizimit të fletëve të kontestuara dhe të procedurave për kontestimin e fletëve të votimit.
7. Duhet marrë masa për të forcuar pavarësinë e transmetuesit publik nga influenca e qeverisë dhe e partive politike me qëllim që ai të zbatojë plotësisht qëllimet e një transmetuesi në shërbim të publikut. Duhet marrë parasysh edhe masa të mëtejshme për ta ulur varësinë e tij nga buxheti i shtetit.
8. Organet shtetërore duhet të bëjnë më shumë përpjekje efektive për të trajtuar problemin e votimit familjar. Kjo çështje duhet theksuar gjatë trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve dhe komisionerëve të qendrave të votimit.
9. Vëmendje mund t'i kushtohet rritjes së gjobës për subjektet zgjedhore që nuk respektojnë kriterin gjinor në listat e kandidatëve, dhe kushtëzimin e përfitimit të fondeve publike për financim të fushatës me respektimin e kriterit gjinor në përputhje me "Udhëzuesin mbi Organizimin e Partive Politike" të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias.

B. REKOMANDIME TË TJERA

LIGJORE

10. Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar për të saktësuar qartë rolin e KZAZ-ve dhe KQZ-së lidhur me zgjedhjet për Kryetar dhe Këshill Bashkiak të Tiranës.
11. Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar në mënyrë që dispozitat mbi financimit e subjekteve zgjedhore me fonde publike të jenë të strukturuar qartësisht si për zgjedhjet vendore ashtu edhe ato parlamentare, në mënyrë që të mos i japin avantazhe të padrejta partive parlamentare.

ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

12. Vëmendje duhet t'i kushtohet përcaktimit të një roli KQZ-së në garantimin e zbatimit të Kodit Zgjedhor lidhur me shpërndarjen e votuesve në qendrat e votimit, numrin maksimal të votuesve për çdo qendër votimi dhe vendndodhjen e QV-ve. Çështja e vendndodhjes së QV-ve në ambiente private duhet trajtuar kohë përpara zgjedhjeve të ardhshme.
13. Vëmendje mund t'i kushtohet faktit që trajnimi zyrtar i organizuar nga KQZ-ja të bëhet i detyrueshëm për të gjithë anëtarët e qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit
14. Mundësia që kanë partitë politike për të zëvendësuar anëtarët e tyre në KZAZ, KQV dhe në grupet e numërimit duhet të kufizohet në raste specifike.
15. KQZ-ja mund të marrë parasysh vendosjen e orari pune për VNV-të. Mund të merret parasysh gjobitja e anëtarëve të grupit të numërimit dhe partive që i kanë emëruar në rast të mosparaqitjes në detyrë apo të refuzimit për të punuar.

LISTAT E ZGJEDHËSVE

16. Kodi Zgjedhor duhet të saktësojë qartë afatin kohor pas së cilit ndryshimet në statusin e regjistrimit të qytetarëve nuk do të pasqyrohen në Listat Përfundimtare të Zgjedhësve.
17. Në mënyrë që të rritet transparenca dhe saktësia e listave të zgjedhësve dhe duke çuar më tej përmirësimet në listat e zgjedhësve të vërejtura në këto zgjedhje, Ministria e Brendshme dhe autoritetet vendore duhet t'i shtojnë përpjekjet për të siguruar që të gjithë zgjedhësit në listat e zgjedhësve të kenë një kod të saktë adrese. Vëmendje mund t'i kushtohet identifikimit të zgjedhësve që dihet që banojnë jashtë vendit.
18. Autoritetet duhet të hetojnë çdo pretendim të veçantë lidhur me shtimin e zgjedhësve në regjistrin civil dhe në listat e zgjedhësve në kundërshtim me ligjin.

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

19. Përjashtimi nga kriteri i mbështetjes me nënshkrime që gëzojnë partitë politike parlamentare duhet të jetë njësoj i vlefshëm edhe për një kandidat të propozuar nga zgjedhësit që ka një mandat në parlament ose në këshillin vendor.

FUSHATA

20. KQZ-së i duhen dhënë burime dhe personel i mjaftueshëm për të përmbushur përgjegjësitë e saj gjatë kontrollit të zbatimit të rregullave mbi financimin e fushatës dhe partive.

MEDIA

21. Duhet ndryshuar kufizimet ligjore mbi reklamën me pagesë në median audiovizive në bazë të përfaqësimit në Kuvend. Koha e transmetimit me pagesë duhet të garantohet në mënyrë të barabartë për të gjithë subjektet zgjedhore, dhe çdo kufizim për kohën e transmetimit me pagesë duhet të zbatohet pa asnjë diskriminim.
22. Sqarimet mbi mbulimin nga media të zgjedhjeve lokale, si ndarja e kohës së transmetimit për kandidatët, partitë politike, koalicionet, aktivitetet qeveritare, duhen trajtuar në një udhëzim të detajuar të KQZ-së që duhet të dalë përpara fillimit të periudhës zyrtare të fushatës.
23. Ligji duhet të saktësojë se si duhet të identifikohen materialet e fushatës të përgatitura për transmetim nga subjektet zgjedhore. Reklamën politike duhet të jenë të dallueshme qartë nga transmetimi i lajmeve dhe programet e tjera.

ANKESAT DHE APELIMET

24. Duhet të rishikohet sistemi i gjyqimit të mosmarrëveshjeve zgjedhore me qëllim që të sigurohen garanci për zgjidhje të efektshme dhe që sistemi të jetë në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe parimet e një procesi të rregullt ligjor. Duhet të ekzistojë mundësia që vendimet e KQZ-së lidhur me nxjerrjen e tabelave të rezultateve të kundërshtohen direkt përpara një trupe gjyqësore sesa përpara vetë KQZ-së.

PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

25. Mund të shtohen përpjekjet për të siguruar pjesëmarrjen e efektshme të komunitetit rom në jetën publike dhe politike, veçanërisht gjatë zgjedhjeve.

NUMËRIMI, MBLEDHJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

26. KQZ-ja duhet t'i nxjerrë menjëherë në internet rezultatet paraprake të detajuara sipas qendrave së votimit, në mënyrë që të rritet transparenca e procesit të nxjerrjes së rezultateve.
27. Ambienti në vendet e numërimit të votave duhet të organizohet në mënyrë të tillë që vëzhguesit të mund të ndjekin të gjitha aspektet e numërimit të votave në mënyrë të plotë. Largësia ndërmjet hapësirës së rezervuar për vëzhguesit, tavolinave të numërimit dhe mbledhjeve të KZAZ-së nuk duhet të jetë e tillë sa ta bëjë të pamundur një vëzhgim efektiv.

RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të respektojnë shtetin e së drejtës, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, të forcojnë dhe të mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të promovojnë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Helsinkit 1992). Kjo pjesë është edhe dimensionin human i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua në Samitin e Parisit në vitin 1990 si Zyra për Zgjedhje të Lira dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një autoritet më të gjerë, në të cilin të përfshiheshin të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot, për këtë organizatë punojnë mbi 130 punonjës.

OSBE/ODIHR-i është organizmi kryesor në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve çdo vit për të vlerësuar nëse zgjedhjet në zonën e OSBE-së janë zhvilluar në përputhje me angazhimet e OSBE-së, standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, dhe me legjislacionin vendas. Metodologjia e vet unike siguron një vështrim në thellësi të tërësisë së një procesi zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, OSBE/ODIHR-i ndihmon shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë fushat e mëposhtme tematike: shtetin e së drejtës, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, migrimin dhe lirinë e lëvizjes, si edhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR-i zbaton një numër programesh asistence çdo vit, duke kërkuar të zhvillojë strukturat demokratike.

Po ashtu, OSBE/ODIHR-i asiston shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të promovuar dhe për të mbrojtur të **drejtat e njeriut** dhe liritë themelore në përputhje me angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor. Kjo arrihet duke punuar me një sërë partnerësh me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e ekspertizës në fusha si të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e trafikuar, edukim dhe trajnim për të drejtat e njeriut, monitorimi i të drejtave të njeriut dhe raportimi mbi to, si edhe të drejtat e njeriu të grave dhe siguria.

Për fushën e **tolerancës** dhe **mosdiskriminimit**, OSBE/ODIHR-i i jep mbështetje shteteve pjesëmarrëse për të forcuar përgjigjet e tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, anti-Semitizmit dhe formave të tjera të intolerancës. Veprimtaritë e OSBE/ODIHR-it në këto fusha përqendrohen në tematikat e mëposhtme: legjislacioni, trajnimi për zbatimin e ligjit, monitorimi, raportimi dhe ndjekja e përgjigjes që u jepet krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja; si edhe aktivitete edukative për të promovuar tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i këshillon shtetet pjesëmarrëse mbi politikën e tyre për komunitetet **rome dhe sinti**. Zyra nxit rritjen e kapaciteteve dhe lidhjet mes komuniteteve rome dhe sinti, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në organet politikëbërëse.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe veprimet në terren të OSBE-së, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it në www.osce.org/odihr.